



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
PREFEKTI I QARKUT ELBASAN
SEKTORI JURIDIK

Nr. 1357 / Prot.

Elbasan më 1 . 1 . 2026

Lënda: Konfirmim akti

KËSHILLIT BASHKIAK BELSH

Në mbështetje të nenit 16 të ligjit nr.107/2016 datë 27.10.2016 “Për Prefektin e Qarkut”, pas verifikimit të ligjshmërisë së aktit tuaj nr.54 datë 24.12.2025 “Për miratimin e taksave dhe tarifave vendore në Bashkinë Belsh për vitin 2026“ konfirmojmë në parim mbështetjen e tij në ligj.

PREFEKTI
Ilir BEJTJA



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA BELSH
KËSHILLI BASHKIAK

1357
29.12.2025
PREFEKTI I QARKUT ELBASAN

Nr. 4389 Prot

Belsh më 29.12 .2025

VENDIM

Nr. 54 .Datë. 24.12 .2025

**“PËR MIRATIMIN E TAKSAVE DHE TARIFAVE VENDORE NË BASHKINË BELSH
PËR VITIN 2026”**

Në zbatim të Ligjit nr 139/2015 “ Për Vetëqeverisjen Vendore”, neni 54 pika f, te Ligjit Nr.9632 datë 30.10.2006 “Per sistemin e taksave vendore”, i ndryshuar, Ligjit nr 9920 datë 19.05.2008 “Për Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, Ligjit Nr.68/2017 “Për Financat e Vetëqeverisjes Vendore”. Me propozim nga zyra e Tatim – Taksave në Bashkinë Belsh, Këshilli Bashkiak :

VENDOSI

1. Të miratojë ndryshimet e taksave dhe tarifave vendore në territorin e Bashkisë Belsh, sipas dokumentit bashkëngjitur “Paketa Fiskale Bashkia e Belsh (e përditësuar)”.
2. Ky vendim hyn në fuqi sipas pikës 6 të nenit 55 të ligjit Nr.139/2015 “Për Vetëqeverisjen Vendore”, dhe pas konfirmimit ligjor nga Institucioni i Prefektit të Qarkut Elbasan.

KRYETARI I KËSHILLIT

Kujtim DERVISHI





REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA BELSH
KESHILLI BASHKIAK

Nr. Prot.

Belsh më / /2025

PLANIFIKIMI I TË ARDHURAVE PËR VITIN 2026

Nr.	Lloji i Taksës	Llogaria	Familjare	Biznes	Urbanistika	Transporti	Tregu	TOTALI
1	Tatim Vendor	7002100	-	20,000	-	-	-	20,000
2	Tatimi i thjeshtuar mbi fitimin	7002200	-	120,000	-	-	-	120,000
3	Tatim mbi token bujqësore	7020100	32,000,000	-	-	-	-	32,000,000
4	Taksë ndërtese dhe banese	7020200	11,200,000	4,400,000	-	-	-	15,600,000
5	Taksa mbi kalimin e të drejtës së pronësisë	7029200	-	-	-	-	-	-
6	Taksë vjetore automjete	7033016	9,450,000	-	-	-	-	9,450,000
7	Takse regjistrim biznesi	7035001	-	2,000	-	-	-	2,000
8	Zënie e hapsirës publike	7035002	-	2,500,000	-	-	300,000	2,800,000
9	Taksa e ndikimit në infrastrukturë dhe të ardhurave nga legalizim	7035003	-	-	3,000,000	-	-	3,000,000
10	Taksa e fjetjes në hotele	7035005	-	50,000	-	-	-	50,000
11	Taksa e tabelës	7035009	-	210,000	-	-	-	210,000
12	Taksas vendore të përkohshme	7035012	-	-	-	-	-	-
13	Tarif Gjelbrimi	7035013	90,000	210,000	-	-	-	300,000
14	Tarif Ndricimi	7035023	1,500,000	1,670,000	-	30,000	-	3,200,000
15	Taks Trualli	7035025	50,000	200,000	-	-	-	250,000
16	Taks vendore per ujin	7035026	170,000	-	-	-	-	170,000
17	Tarif për përdorim çertifikat	7035028	-	-	194,000	-	-	194,000
18	Tarif per autorizim urbanistik	7035029	25,000	-	-	-	-	25,000
19	Tarif per leje zhvillimi	7035032	50,000	-	-	-	-	50,000
20	Tarif per vertetim	7035033	10,000	48,000	-	-	-	58,000
21	Tarif per leje ndertimi	7035040	2,866,800	-	-	-	-	2,866,800
22	Tarif per leje Transporti	7110106	-	-	-	220,000	-	220,000
23	Qira toke	7109200	1,000,000	-	-	-	-	1,000,000
24	Qira nga objektet/ndërtesat	7109600	-	234,200	-	-	-	234,200
25	Taksë pastrimi dhe higjene	7110501	7,600,000	7,450,000	-	250,000	-	15,300,000
26	Tarifa të tjera administrative	7110599	100,000	4,100,000	-	-	-	4,200,000
27	Të ardhura miratim projekti MNZSH	7113009	-	-	-	-	-	-
28	Të ardhura nga Shërbimi MNZSH	7113011	70,000	-	-	-	-	70,000
29	Gjoha	7115420	25,000	-	-	25,000	-	50,000
30	Kamat Vonesa	7115500	-	350,000	-	-	-	350,000
31	Te ardhura te tjera jo tatimore	7190990	60,000	-	-	-	-	60,000
32	Taksë e Rentës Minerare	7204100	-	100,000	-	-	-	100,000
33	Tatim mbi të ardhurat personale	7204102	9,250,000	-	-	-	-	9,250,000
	TOTALI		75,516,800	21,664,200	3,194,000	525,000	300,000	101,200,000

KRYETARI I KESHILLIT

Kujtim DITRIVISHI



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA BELSH

Nr 4319 Prot

Belsh më 19 . 12 .2025

PROJEKT-VENDIM

Nr. .Datë. . .2025

**“PËR MIRATIMIN E TAKSAVE DHE TARIFAVE VENDORE NË BASHKINË BELSH
PËR VITIN 2026”**

Në zbatim të Ligjit nr 139/2015 “ Për Vetëqeverisjen Vendore”, neni 54 pika f, te Ligjit Nr.9632 datë 30.10.2006 “Per sistemin e taksave vendore”, i ndryshuar, Ligjit nr 9920 datë 19.05.2008 “Për Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, Ligjit Nr.68/2017 “Për Financat e Vetëqeverisjes Vendore”.

PROPOZOJMË

1. Të miratojë ndryshimet e taksave dhe tarifave vendore në territorin e Bashkisë Belsh, sipas dokumentit bashkëngjitur “Paketa Fiskale Bashkia e Belsh (e përditësuar)”.
2. Bashkagjitur këtij Projekt Vendimi po ju paraqesim Planifikimin e të Ardhurave për vitin 2026.
 1. Zyrës Tatim-Taksave. Ditjon Pepa
 2. Drejtoria e Shërbimeve Mbështetëse. Anxhelina Qypi
 3. Sektori i Mjedisit dhe Pronave Publike. Anxhela Dervishi
 4. Sektori i Transportit. Julgin Rika
 5. Drejtoria e Planifikimit, Kontrollit, Mjedisit dhe Pronave Publike. Ndriçim Reka
 6. Sektori i planifikimit Urban. Santiljano Kasa
 7. Drejtoria e Shërbimeve Utilitare, Kombëtare dhe Administrative. Pr.Ramadan Çekrezi
 8. Sektori Policis Bashkiake. Agron Hysa
 9. Sektori IVMT. Enian Ferhati

KRYETARI
Arif LAJANI



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA BELSH

DREJTORIA E SHËRBIMEVE FINANCIARE E TË ARDHURAVE VENDORE
SEKTORI I TË ARDHURAVE VENDORE

Nr. — Prot.

Belsh më 19.12.2025

PLANIFIKIMI I TË ARDHURAVE PËR VITIN 2026

Nr.	Lloji i Taksës	Llogaria	Familjare	Biznes	Urbanistika	Transporti	Tregu	TOTALI
1	Tatim Vendor	7002100	-	20,000	-	-	-	20,000
2	Tatimi i thjeshtuar mbi fuqimin	7002200	-	120,000	-	-	-	120,000
3	Tatim mbi token bujqësore	7020100	32,000,000	-	-	-	-	32,000,000
4	Takse ndërtese dhe banese	7020200	11,200,000	4,400,000	-	-	-	15,600,000
5	Taksa mbi kalimin e te drejtes se pronesise	7029200	-	-	-	-	-	-
6	Taksë vjetore automjete	7033016	9,450,000	-	-	-	-	9,450,000
7	Takse regjistrim biznesi	7035001	-	2,000	-	-	-	2,000
8	Zëme e hapsirës publike	7035002	-	2,500,000	-	-	300,000	2,800,000
9	Taksa e ndikimit ne infrastrukture dhe te ardhurave nga legalizim	7035003	-	-	3,000,000	-	-	3,000,000
10	Taksa e fjetjes ne hotele	7035005	-	50,000	-	-	-	50,000
11	Taksa e tabelës	7035009	-	210,000	-	-	-	210,000
12	Taksas vendore te perkohshme	7035012	-	-	-	-	-	-
13	Tarif Gjelbrimi	7035013	90,000	210,000	-	-	-	300,000
14	Tarif Ndricimi	7035023	1,500,000	1,670,000	-	30,000	-	3,200,000
15	Taks Trualli	7035025	50,000	200,000	-	-	-	250,000
16	Taks vendore per ujin	7035026	170,000	-	-	-	-	170,000
17	Tarif per perdorim çertifikat	7035028	-	-	194,000	-	-	194,000
18	Tarif per autorizim urbanistik	7035029	25,000	-	-	-	-	25,000
19	Tarif per leje zhvillim	7035032	50,000	-	-	-	-	50,000
20	Tarif per vertetim	7035033	10,000	48,000	-	-	-	58,000
21	Tarif per leje ndertim	7035040	2,866,800	-	-	-	-	2,866,800
22	Tarif per leje Transporti	7110106	-	-	-	220,000	-	220,000
23	Qira toke	7109200	1,000,000	-	-	-	-	1,000,000
24	Qira nga objektet/ndertesat	7109600	-	234,200	-	-	-	234,200
25	Taksë pastrimi dhe higjene	7110501	7,600,000	7,450,000	-	250,000	-	15,300,000
26	Tarifa te tjera administrative	7110599	100,000	4,100,000	-	-	-	4,200,000
27	Te ardhura miratim projekti MNZSH	7113009	-	-	-	-	-	-
28	Te ardhura nga Sherbimi MNZSH	7113011	70,000	-	-	-	-	70,000
29	Gjoha	7115420	25,000	-	-	25,000	-	50,000
30	Kamat Vonesa	7115500	-	350,000	-	-	-	350,000
31	Te ardhura te tjera jo tatimore	7190990	60,000	-	-	-	-	60,000
32	Takse e Rentes Minerare	7204100	-	100,000	-	-	-	100,000
33	Tatim mbi te ardhurat personale	7204102	9,250,000	-	-	-	-	9,250,000
	TOTALI		75,516,800	21,664,200	3,194,000	525,000	300,000	101,200,000

Pergjegjesi i Sektorit te Ardhurave Vendore
Driton PEPA

Drejtori i te Ardhurave Vendore dhe Finances
Alban NIPOLLI

KRYETARI I BASHKISE
Antoni VALLI





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA BELSH
DREJTORIA E SHËRBIMEVE FINANCIARE E TË ARDHURAVE VENDORE
SEKTORI TATIM – TAKSAVE

Nr 4324 Prot

Belsh më 19. 12. 2025

RELACION MBI PARASHIKIMIN E TE ARDHURAVE

1. **Tatim vendor**, është parashikuar si pasojë e detyrimeve të prapambetura që ka biznesi i vogël ndaj Bashkisë Belsh në vitet që ky tatim ka qënë mbledhur pranë zyrave vendore të Taksave dhe Tatimeve.
2. **Tatim i thjeshtuar mbi fitimin**, është parashikuar në bazë të faktit të vitit 2025, të ardhura të transferuara nga Drejtoria Rajonale e Tatimeve Elbasan.
3. **Tatim mbi tokën bujqësore**, ky parashikim vjen pasi vlera vjetore në Bashkinë Belsh, përfshire Njësite Administrative, arrin në një vlerë vjetore prej 15 446 969 lekë sipas kategoris me 30% zbritje. Nisur nga fakti i vitit 2025 taksa mbi tokën bujqësore është parashikuar duke marrë si bazë jo vetëm totalin e arkëtueshëm për një vitë kalendarik por duke futur dhe pjesë të borxhit të papaguar nga familjet që kanë përfituar tokë me ligjin e 7501.
4. **Taksë ndërtese dhe banese**, llogaritet si detyrim vjetor i taksës së banesës, (*mbeshtetur ne VKM nr.132, datë 7.3.2028 e ndryshuar*), për njësi pronore(objekt shtëpi banimi) dhe taksa e biznesit(ndertes).
5. **Taksë vjetore për automjete**, kjo taksë planifikohet në bazë të dhënave të marra nga Drejtoria e Përgjithshme e Transporteve Rrugore ne rolin e agjentit tatimor i cili bazohet në të dhënat e regjistruara për nivelin e taksave dhe numrin e automjeteve.
6. **Taksë për zënie hapësire publike**, Ështe planifikuar kryesisht për hapësirat ne shfrytezimit në Sheshin Ansambli por edhe hapësirat publike ne Bashkin Belshe (periferi).
7. **Taksë ndikimi në infrastrukture**, është parashikuar duke u nisur nga një pritshmëri e lartë për legalizimin e objekteve për individët që janë banorë të Bashkisë Belsh si dhe nga detyrimi i prapambetur nder vite.
8. **Taksë tabelle**, është përlllogaritur në bazë të kërkesave të subjekteve për vendosje tabelle sipas ligjit 9632, datë 30.10.2006 "Për sistemin e taksave vendore", i ndryshuar, dhe për subjektet që kanë tabela ekzistuese.
9. **Tarifë gjelbërimi**, kjo tarifë është parashikuar në bazë të numrit të familjareve (*Belsh Qëndër*) dhe bizneseve të cilët paguajnë tarifën e gjelbërimit.
10. **Tarifë ndriçimi**, është përlllogaritur në bazë të numrit të subjekteve fizike, juridike dhe të abonentëve familjare të cilëve u ofrohet shërbimi i ndriçimit.
11. **Taksa e fjetjes në hotele** parashikohet nga shitimi i hoteleri turizmit në Bashkinë Belsh.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

12. **Taksë trualli**, të ardhurat nga taksa e truallit është apikueshme për trojet me destinacion ndërtimin dhe zhvillimin urban, me pronar individin gjithashtu edhe për subjektet fizik juridik që ushtrojnë aktivitet në territorin e Bashkis.
13. **Taksë vendore për ujë**, kjo taksë është parashikuar në bazë të arketimeve të kryera gjatë vitit 2025 si rrjedhojë e investimit të kryer në mirembajtjen dhe funksionimin e kanaleve ujiteëse/vaditesë dhe si kërkesë e popullatës për vaditje për tokën buqësore.
14. **Tarifë për leje ndërtimi**, është parashikuar si një e ardhur në pritshmeri për ndërtimin e objekteve të reja në territorin e Bashkis Belsh.
15. **Tarifë për leje transporti**, për liçenca, tarifën e parkimit, tarifën ton/kapacitet e transportit janë parashikuar për subjektet e transportit që pritet të bëjnë rinovime të lejeve në Bashkinë Belsh për vitin 2025.
16. **Qira toke**, Kjo taksë është parashikuar si e ardhur për vitin 2025 si pasoi e kontratave të lidhura nga Bashkia Belsh me subjekte fizik/juridik të cilët kanë marrë në shfrytëzim një sipërfaqe toke me qera në baze të ligjeve në fuqi.
17. **Qira nga objektet/ndërtesat**, janë përlogaritur si shumë e detyrimeve që kanë për të shlyer subjekte të ndryshme që kanë një kontratë me Bashkinë Belsh, gjithashtu si rezultat i kontratave të reja që do të lidhen me subjektet ekzistuese që janë përfitues nga zbatimi i projektit të fasadave në Bashkinë Belsh.
18. **Tarifë pastrimi dhe higjienë**, është parashikuar si tarifë për familjet në territorin e Bashkisë (6400 familje), për bizneset e mëdha, bizneset e vogla, subjekteve të transportit dhe subjekteve private të transportit të mallit që pritet të shlyejnë detyrimet e tyre për vitin 2025 në të gjithë territorin e Bashkisë Belsh.
19. **Tarifa të tjera administrative**, është llogaritur si një e ardhur nga tarifa dhe rregullore, është parashikuar në rritje si rezultat i të ardhurave të realizuara në vitin 2025.
20. **Te ardhura nga MNZSH**, kjo e ardhur mbështetet në të ardhurat e realizuara për vitin 2025 nga miratimi i projekteve dhe nga shërbimi i kryer nga MNZSH.
21. **Gjoha**, parashikohen si rezultat i zbatimit të gjobave dhe kundravajtjeve administrative duke u mbështetur në të ardhurat e realizuara nga viti 2025.
22. **Kamatvonesa**, vendoset kur detyrimi tatimor nuk paguhet në afatë, tatimpaguesi është i detyruar që për periudhën nga afati i pagesës deri në datën e pagesës të tatimit, të paguaj kamatvonesë për këtë shumë si dhe për subjektet debitore.
23. **Taksa e rentës minerare** parashikohet si e ardhur nga aktiviteti gurorë (gerrirë), ku renta llogaritet si detyrimi mujor i subjektit taksapagues, në çastin kur ai shet produktin minerar 5 % (përqindje) të ardhurave të takon pushtetit vendor. Këto të ardhura transferohen nga Drejtoria Rajonale e Tatimeve Elbasan në rolin e agjentit.
24. **Tatimi mbi të ardhurat personale**, është parashikuar si pasoi e aplikimit të tatimit mbi të ardhurat personale për territorin e Bashkis Belsh ky parashikim mbështetet në të ardhurat e realizuara për vitin 2025.

Përgj. Sektorit të Ardhurave
Dijon PEPA

Drejtori Financës
Alban NIPOLLI

Adresa: Qarku Elbasan, Belsh Qender, Rruga Haziz Dervishi, bashkiabelsh@hotmail.com



PAKETA FISKALE
BASHKIA BELSH
(e përditësuar)

“Për një qeverisje vendore që synon të rrisë kapacitetet fiskale dhe administrative për realizimin e funksioneve në përgjegjësinë e saj, përmes taksimit të drejtë, gjithpërfshirëse e me përgjegjësi sociale”

Dhjetor, 2025



Adresa: Qarku Elbasan, Belsh Qender, Rruga Haziz Dervishi.

bashkiabelsh@hotmail.com

Pëmbajtja:

1. Mbi Bashkinë Belsh
2. Çfarë prezanton Paketa Fiskale
3. Kuadri Ligjorë dhe Nënligjor

NIVELI I TAKSAVE DHE TARIFAVE PËR VITIN 2026 :

❖ TAKSAT VENDORE

Kapitulli I:

1. Taksa mbi pasurinë e paluajtshme;
 - a) Taksa mbi ndërtesat.
 - b) Taksa mbi tokën bujqësore.
 - c) Taksa mbi truallin.
2. Taksa e fjetjes në hotel;
3. Taksa e ndikimit në infrastrukturë nga ndërtimet e reja;
 - a) Kontributi i sektorit privat në krijimin e fondit publik të banesave sociale
 - b) Për autorizime punimesh.
 - c) Garanci financiare për subjektet fizike/juridike, kërkues i lejes për ndërtimin, riparimin, restaurimin apo shembjen e objektit.
4. Taksa mbi kalimin e të drejtës së pronësië për pasuritë e paluajtshme;
5. Taksa e tabelës;

❖ TAKSAT E NDARA

Kapitulli II:

1. Taksa e ndara;
 - a) Taksa e mjeteve të përdorura të transportit.
 - b) Taksa e rentës minerare.
 - c) Të ardhura nga tatami mbi të ardhurat personale.

❖ TARIFAT VENDORE

Kapitulli III:

1. Tarifë Vendore;



- a) Tarifë pastrimi, Tarifë Ndrëimi, Tarifë Gjëlberimi, Tarifë Zgjatje orari Non Stop, Tarifë Shërbimi në tregje, Tarifë Vërtetim, Tarifë për vaditje,
- b) Tarifë për dhënie në përdorim të ambjenteve,
- c) Tarifë për zënie e hapësirës publike.

2. Tarifë për Transportin;

- a) Tarifa për liçensa/autorizime/çertifikata.
- b) Tarifë për liçencë për tregtimin e hidrokarbureve dhe nënprodukteve të tyre.

3. Tarifat Vendore për Pyjet dhe Kullotat në Sektorin e Bujqësisë :

- a) Tarifa për pyjet dhe kullotat.
- b) Tarifa për sektorin e bujqësisë.

❖ GJOBAT DHE KUNDRAVAJTJE ADMINISTRATIVE

Kapitulli VI:

I. Gjopa dhe Kundravajtje Administrative;

❖ TË ARDHURA JO TATIMORE

- a) Të ardhura nga dhënie me qira e aseteve në pronësi të Bashkisë
- b) Të ardhura nga sekuestrime dhe zhdëmtime.
- c) Të ardhura nga shitja e mallrave dhe e shërbimeve.
- d) Të ardhura nga shitja e aktiveve të qëndrueshme të trupëzuar
- e) Të ardhura nga privatizimi

1. Mbi Bashkinë Belsh

Bashkia Belsh ndodhet në Pllajën e Dumresë, e cila ndodhet midis lumit Devoll , lumit Shkumbin dhe fushës së Myzeqes. Bashkia Belsh ka një sipërfaqe prej 196 km², nga ku kemi, zona urbane 8.93 km², tokë bujqëore 131.81 km², kullotë 1.36 km², pyje 15.9 km², sipërfaqe(ujore, shkëmbore, livadhe, ledh, përrua) 38 km². Me relief kryeshit kodrinor, me altitudat mesatarisht rreth 50-350 m lartësi, me 84 liqene dhe depresjone(gropa) karstike të shpërndara në të gjithë territorin. E pozicionuar në qendër të Shqipërisë dhe afërsia me qendrat e mëdha urbane e bëjnë Belshin një atraksjon turistik për tu vizituar. Cilësia infrastrukture, politikat zhvillimore të Bashkisë Belsh dhe veprimet tona i japin vlerë zhvillimit të qëndrueshëm, mbrojtjes së burimeve natyrore dhe traditave tona kulturore. Ndaj problem kryesorë është gjetja e mundësive që të kthejmë këtë shumëllojshmëri në avantazh konkures dhe çdo territor të kontribuojë në mirëqënien e qytetarve dhe të Bashkisë. Për të mundësuar këtë mjedis do të fokusojmë punën në përdorimin efektiv të burimeve njerëzore, fizike dhe financiare.

Në bazë të ligjit Nr.115/2014. "Për ndarjen adminisdtrativo-territoriale të njësisve të qeverisjes vendore në Republikën e Shqipërisë", Njësia Administrative Belsh quhet zona urbane që përmblihte Bashkia Belsh përpara ndarjes së re territorial.



Po sipas këtij ligji, Njësi Administrative të tjera, quhen zonat sipas tabelës, të cilat ishin Komuna Përpara ndarjes së re territoriale.

Tabela.Ndarja në fshatra në Njësitë Administrative të Bashkisë Belsh.

Nr.	BASHKIA	Qendra e Bashkisë	Njësitë administrative përbërëse	Qytetet dhe fshatrat në përbërje të tyre
1.	BELSH	Qyteti Belsh	Belsh	Fshatrat: Belsh Qëndër, Çepe, Dushk, Belsh, Stanaj, Shkozë, Qafë Shkallë, Seferan, Trojas, Shkëndi, Gradisht, Marinëz, Shtith
2.			Grekan	Fshatrat: Grekan, Dëshiran, Guras, Rrenës
3.			Kajan	Fshatrat: Kajan, Dragot, Lisaj, Dragot-Dumre, Gjinuk, Gjolen, Turbull, Çestije, Merhoj, Drizaj
4.			Fierzë	Fshatrat: Fierzë, Hardhi, Çerragë, Kosovë
5.			Rrasë	Fshatrat: Rrasë e Sipërme, Shegas, Guri i Bardhë, Rrasë e Poshtme

2. Çfarë Prezanton Paketa Fiskale?

Vizioni ynë, për një territor bashkiak të integruar, parashikon planifikim dhe investime që krijojnë mundësi për një zhvillim të qëndrueshëm të balancuar për të gjithë territorin, duke mbrojtur burimet natyrore. Kjo qasje bazohet në përforsimin e identitetit të secilës zonë të Bashkisë, duke patur parasysh burimet natyrore, profilin ekonomik dhe produktet, shtrirjen e shërbimeve dhe traditën, me synimin e përhershëm të rritjes së nivelit të jetesës. Miradministrimi i burimeve financiare nëpërmjet planifikimit sa më real të të ardhurave si dhe batimi me rigorozitet i rregulloreve dhe urdhëresave, zbatimi i ligjit përbën moton e punës tonë.

Planifikimin e kemi mbështetur në shpërndarjen sa më të drejtë të ngarkesës tatimore duke bërë përcaktimin i nivelit të tarifës sipas llojit të aktivitetit, sipas vendndodhjes gjeografike, duke lehtësuar bizneset në zonat më pak të zhvilluara.

Ne synojmë që të kemi në dorë një mekanizëm i cili na ndihmon për të arritur objektivat në realizimin e prioriteteve të identifikuara në planet tona strategjike më afatgjata. Përfshirja e qytetarëve, grupeve të interesit, komunitetit në përgjithësi, mbetet pikë kyçe e Suksesit jo vetëm në hartimin e politikës fiskale, por sidomos për zbatimin e saj.

Nga analiza e ecurisë së realizimit të të ardhurave të deritanishme rezulton se ka burime akoma të pashfrytëzuara në kapacitetet optimale. Kjo vërehet pothuaj në të gjitha njësitë administrative.

Bazuar në të gjitha sa më sipër, ju paraqesim paketën fiskale me ndryshimet e propozuara. Propozimet janë në përputhje me ndryshimet ligjore të ndodhura. Ato konsistojnë në përmirësime teknike dhe proceduriale, duke patur parasysh që paketa fiskale është e integruar, gjithëpërfshirëse dhe afatgjatë.

Në mënyrë të përmbledhur kjo paketë fiskale synon:

- Përditësimin dhe aplikimin e kornizës ligjore të ndryshuar;
- Përditësimin e procedurave, afateve, aktorëve, veprimeve, përgjegjësive për vjeljen e çdo takse dhe tarife, pjesë e kësaj pakete fiskale.
- Përmirësimin e sistemit fiskal eficient dhe transparent;
- Përcaktimin qartë në seksione të taksave dhe tarifave.
- Është synuar në një:
 - ✓ Taksim të drejtë;
 - ✓ Tarifim të mbështetur në kosto shërbimi;



- ✓ Klasifikim i biznesit sipas qarkullimit vjetor, llojit të aktivitetit, vendodhjes, etj.
- f. Aplikimi i incentivave, lehtësirave fiskale, përjashtimeve për grupe të caktuara taksapaguesish në nevojë, për aq sa lejon dhe lejon ligji.

3. KUADRI LIGJOR DHE NËNLIGJOR

Ligji nr 9632, datë 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore”, i ndryshuar, përbën ligjin bazë për reformat e decentralizimit të pushtetit vendor dhe përcakton rregullat për ushtrimin e të drejtave dhe detyrave të njësisve të qeverisjes vendore në drejtim të krijimit të taksave vendore, mbledhjen dhe administrimin e tyre.

Bazuar në Ligjin nr.139/2015, datë 17.12.2015 “Për vetqeverisjen vendore”, Ligji nr 9632, datë 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore”, i ndryshuar, Ligjin 68/2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore” dhe Ligjin nr.9975, datë 28.7.2008 “Për taksat kombëtare”, i ndryshuar, në të ardhurat vendore përfshihen kryesisht:

- ✓ Taksa mbi pasurinë e paluajtshme;
- ✓ Taksa e ndikimit në infrastrukturë për ndërtimet e reja;
- ✓ Taksa e fjetjes në hotel;
- ✓ Taksa mbi kalimin e të drejtës së pronësisë për pasuritë e paluajtshme;
- ✓ Taksa e tabelës/reklamat;
- ✓ Taksa e mjeteve të përdorura të transportit;
- ✓ Taksa e rentës minerare;
- ✓ Të ardhura nga tatimi mbi të ardhurat personale;
- ✓ Taksa të përkohshme;
- ✓ Tarifa për shërbime;

Detyrimet për taksat dhe tarifatat vendore, për taksapaguesit e biznesit, institucionet, individët dhe familjet përlllogariten duke filluar nga data 1 janar deri më 31 dhjetor të çdo viti. Më poshtë në mënyrë të përmblodhur jepet legjislacioni fiskal vendor, i cili është konsultuar për të hartuar këtë paketë fiskale.

❖ Ligje:

- ✓ Ligji nr 9632, datë 30.10.2006 "Për sistemin e taksave vendore", ndryshuar me Ligji nr. 9745 datë 28.05.07; ndryshuar me Ligjin nr. 9764, datë 09.07.2007; ndryshuar me Ligjin nr. 9931, datë 09.06.2008; ndryshuar me Ligjin nr. 10 073, datë 9.2.2009; ndryshuar me Ligjin nr. 10117 dt. 23.4.2009; ndryshuar me Ligjin nr. 10146 dt.28.9.2009; ndryshuar me Ligjin Nr. 10354 , datë 18.11.2010; ndryshuar me Ligjin nr. 10457, datë 21.07.2011; ndryshuar me Ligjin nr. 106/2013, datë 28.3.2013; ndryshuar me Ligjin nr. 181/2013, datë 28.12.2013; ndryshuar me Ligjin nr. 85/2014, datë 17.07.2014; ndryshuar me Ligjin nr. 181/2013, dt. 28.12.2013; ndryshuar me Ligjin nr. 142/2015, datë 17.12.2015; ndryshuar me Ligjin nr.106/2017; ndryshuar me Ligjin Nr. 41/2018;Aktin Normativ Nr. 3, datë 2.10.2019; ndryshuar me Ligjin Nr. 122/2020, datë 15.10.2020; ndryshuar ligjin nr.29/2023, datë 30.3.2023; ndryshuar me ligjin nr.67/2023, datë 21.7.2023.
- ✓ Ligji nr.139/2015, datë 17.12.2015 “Për vetqeverisjen vendore” i ndryshuar;
- ✓ Ligji nr. 8438 datë 28.12.1998, “Për tatimin mbi të ardhurat”, ndryshuar me ligj nr. 106/2020.
- ✓ Ligji nr.9723, datë 3.5.2007 “Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit”, i ndryshuar;



- ✓ Ligji nr. 9920, datë 19.5.2008 "Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar;
- ✓ Ligji nr.10081, datë 23.2.2009, "Për licencat, autorizimet dhe lejet në Republikën e Shqipërisë" i ndryshuar";
- ✓ Ligji nr. 10304, datë 15.7.2010, "Për sektorin minerar në Republikën e Shqipërisë";
- ✓ Ligji nr.9975, datë 28.7.2008 "Për taksat kombëtare", i ndryshuar;
- ✓ Ligji nr. 93/2015 "Për turizmin", i ndryshuar;
- ✓ Ligji Nr. 9482, datë 03.04.2006 "Për legalizimin, urbanizimin dhe integrimin e ndërtimeve pa leje", i ndryshuar;
- ✓ Ligji Nr 107/2014 "Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit", i ndryshuar;
- ✓ Ligji Nr.10465, datë 29.9.2011 "Për shërbimin veterinar në Republikën e Shqipërisë"; ndryshuar me Ligjin nr. 71/2020 "Për disa ndryshime dhe shtesa në Ligjin nr. 10465, datë 29.09.2011 "Për shërbimin veterinar në Republikën e Shqipërisë";
- ✓ Ligji Nr.8450, datë 24.2.1999 "Për përpunimin, transportimin dhe tregtimin e naftës, të gazit dhe nënprodukteve të tyre", i ndryshuar;
- ✓ Ligji. Nr. 9385, datë 4.5.2005 "Për pyjet dhe shërbimin pyjor", shfuqizuar me Ligjin nr. 20/2020
- ✓ Ligji Nr. 9693, datë 19.3.2007 "Për fondin kullosor", i ndryshuar;
- ✓ Ligji Nr. 10279, datë 20.05.2010 "Për kundravajtjet administrative", i ndryshuar;
- ✓ Ligji Nr.8744, datë 22.2.2001 "Për transferimin e pronave të paluajtshme publike të shtetit në njësitë e qeverisjes vendore", i ndryshuar;
- ✓ Ligji Nr.10296, datë 08/07/2010, "Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin", i ndryshuar;
- ✓ Ligji nr. 10463, datë 22.9.2011, "Për menaxhimin e integruar të mbetjeve", i ndryshuar;
- ✓ Ligji nr. 152/2015, datë 21.12.2015, "Për shërbimin e mbrojtjes nga zjarri dhe shpëtimin";
- ✓ Ligji. nr. 68/2017 "Për financat e vetëqeverisjes vendore";
- ✓ Ligji nr. 22/2018 "Për strehimin social";
- ✓ Ligji nr. 8402, datë 10.9.1998 "Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit"(ndryshuar me ligjet: nr. 9200, datë 26.2.2004; nr.9794, datë 23.7.2007; nr.9826, datë 11.11.2007; nr.10324, datë 23.9.2010; vendimin e gjykatës kushtetuese nr.23, datë 8.6.2011; nr.11/2012, datë 9.2.2012; nr.20/2013, datë 14.2.2013; ndryshuar me ligjin nr. 3/2020, datë 30.1.2020) (përditësuar)
- ✓ Ligji Nr.107 datë 31.07.2014 "Për Planifikimin dhe Zhvillimin e Territorit", ndryshuar me Ligjin Nr. 119/2020;
- ✓ Ligji nr.24/2017 "Për administrimin e ujitjes dhe kullimit";
- ✓ Ligji nr. 57/2020 "Për pyjet";
- ✓ Ligji nr.111/2018 "Për kadastrën" i ndryshuar;

❖ Vendime dhe udhëzime:

- ✓ Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 505, datë 1.8.2007 "Për miratimin e Statutit të Qendrës Kombëtare të Regjistrimit";
- ✓ Vendimi i Këshillit të Ministrave, nr. 783, datë 10.11.2011, "Për procedurat e ndarjes së të ardhurave të taksës vjetore të mjeteve të përdorura me njësitë e qeverisjes vendore";
- ✓ VKM Nr.7, datë 4.01.2012, "Për përcaktimin e procedurave dhe të dokumentacionit të nevojshëm për arkëtimin e taksës së rentës minerare", i ndryshuar.
- ✓ VKM Nr. 970, dt 02.12.2015 "Për përcaktimin e procedurave dhe të kushteve për dhënien e licencave për tregtimin e naftës bruto dhe nënprodukteve të saj" i ndryshuar me VKM Nr.344, datë 19.4.2017 ;
- ✓ VKM Nr. 396, datë 21.6.2006 "Për kriteret e transferimit dhe të përdorimit të pyjeve nga njësitë e qeverisjes vendore", i ndryshuar.;
- ✓ VKM nr. 391 datë 21.06.2006 "Për përcaktimin e tarifave në sektorin e pyjeve dhe kullotave"; i ndryshuar.



- ✓ VKM 632 datë 11.06.2009 “Për tarifatat në sektorin e Kullotave”, i ndryshuar.
- ✓ VKM nr.1064 datë 22.12.2010 “Për disa ndryshime në VKM nr. 391 datë 21.06.2006 “Për përcaktimin e tarifave në sektorin e pyjeve dhe kullotave”; i ndryshuar.
- ✓ VKM Nr nr.285, datë.19.05.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”;
- ✓ VKM nr. 54, datë 05.02.2014 “Për përcaktimin e kritereve, dhënies me qira, enfiletozë apo kontrata të tjera të pasurisë shtetërore”, i ndryshuar. Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 992, datë 9.12.2015 “Për disa ndryshime në vendimin nr.54, datë 5.2.2014, të Këshillit të Ministrave, “Për përcaktimin e kritereve, procedurës dhe mënyrës së dhënies me qira, enfiletoze apo kontrata të tjera të pasurisë shtetërore”, të ndryshuar;
- ✓ VKM Nr.469, datë 3.6.2015, "Për përcaktimin e vlerës minimale të çmimit të referencave të qirave të ndërtesave për qëllime tatimore";
- ✓ VKM Nr. 575, datë 24.6.2015 “Për miratimin e kërkesave për menaxhimin e mbetjeve inerte”;
- ✓ VKM Nr. 285, date 27.6.2002 “Për tarifatat e shërbimeve që kryen policia e mbrojtjes nga zjarri dhe shpëtimit ndaj shtetasve dhe personave, juridikë e fizikë, vendas e të huaj”; shfuqizuar me VKM Nr. 607, datë 29.7.2020 “Për tarifatat për llojet e shërbimeve që ofrohen nga shërbimi i mbrojtjes nga zjarri dhe shpëtimit” në mbështetje të ligjit nr. 152/2015, "Për Shërbimin e Mbrojtjes nga Zjarri dhe Shpëtimit", me propozim të ministrit të Brendshëm, Këshilli i Ministrave
- ✓ VKM Nr.1108, date 30.12.2015 “Për transferimin, nga Ministria e Bujqësisë, Zhvillimit rural dhe Administrimit të ujërave të Bashkitë, të infrastrukturës së ujitjes dhe kullimit, të personelit dhe të aseteve të luajtshme e të paluajtshme të Bordeve Rajonale të Kullimit”;
- ✓ VKM nr. 408, datë 13.05.2015 “Për miratimin e rregullores së zhvillimit të territorit”;
- ✓ VKM nr. 132, datë 7.3.2018 për “Metodologjinë për përcaktimin e vlerës së taksueshme të pasurisë së paluajtshme “ndërtesa”, e bazës së taksës për kategori specifike, natyrën dhe prioritetin e informacionit dhe të dhënave për përcaktimin e bazës së taksës, si dhe të kritereve dhe rregullave për vlerësimin alternative të detyrimit të taksës”, ndryshuar me VKM nr. 168, datë 27.3.2019, VKM Nr. 144, datë 13.2.2020, dhe VKM Nr. 457, datë 26.7.2023.
- ✓ VKM-në nr 475, datë 30.07.2021 “Për bashkëpunimin e njësisve të vetqeverisjes vendore me shërbimin veterinar”.
- ✓ VKM nr 230, datë 20.03.2013 “Për përcaktimin e funksioneve, detyrave specifike dhe standardeve të shërbimit veterinar të qeverisjes vendore”, shfuqizuar nga Ligji nr. 71/2020.
- ✓ VKM nr. 418, datë 27.5.2020 “ Për miratimin e dokumentit të politikave strategjike dhe të planit kombëtar për menaxhimin e integruar të mbetjeve, 2020–2035”.
- ✓ VKM nr. 171, datë 27.03.2019 të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e rregullores “Për kushtet dhe kriteret e ushtrimit të veprimtarisë së stacionit të plazhit”, i ndryshuar
- ✓ Vendimin e Këshillit të Ministrave nr.707,datë 12.10.2016 “Për tarifën e shërbimit të mbrojtjes nga zjarri dhe shpëtimi, të ofruar nga bashkitë e paisura me stacione të këtij shërbimi, në territorin e bashkive që nuk kanë stacione të shërbimit të MZSH-së”;
- ✓ Vendimin e Këshillit të Ministrave nr.748, datë 09.11.2016 “Për mënyrën dhe kriteret e llogaritjes së shpenzimeve për shuarjen e zjarreve në objektet e siguruar nga zjarri dhe administrimin e përdorimit të ardhurave, për llogaritjen e shërbimit vendor MZSH-së”;
- ✓ Vendimin e Këshillit të Ministrave nr.433, datë 08.06.2016 “Për transferimin në pronësi të bashkive të pyjeve dhe të kullotave publike, sipas listave të inventarit dhe aktualisht në administrim të Ministrisë së Mjedisit e të ish komunave/bashkive”;
- ✓ Vendimin e Këshillit të Ministrave nr.783,datë 10.11.2011 “Për procedurat e ndarjes së të ardhurave të taksës vjetore të mjeteve të përdorura me njësitë e qeverisjes vendore”, i ndryshuar;
- ✓ VENDIM Nr. 325, datë 29.5.2024 “Përcaktimin e rregullave për kontributin e sektorit privat për krijimin e fondit publik të banesave sociale”.



- ✓ Udhëzim Nr. 81, datë 6.3.2020 “Për klasifikimin e objekteve, sipas rrezikshmërisë nga zjarri, procedurat e shqyrtimit dhe të miratimit të projektit të mbrojtjes nga zjarri dhe shpëtimin, si dhe dhënia e certifikatës së sigurisë nga zjarri”, në mbështetje të ligjit nr. 152/2015, “Për shërbimin e mbrojtjes nga zjarri dhe shpëtimin”.
- ✓ Udhëzimi nr. 1, datë 16.06.2011 “Për disa ndryshime në udhëzimin nr. 3, datë 15.02.2001 të KM “Për mbikqyrjen dhe kolaudimin e punimeve të ndërtimit”, të ndryshuar, pika 4.
- ✓ Udhëzim i Ministrit të Financave Nr.1, datë 12.1.2007 “Për përcaktimin e veprimtarive që trajtohen si veprimtari, tregtare apo shërbimi, ambulante si dhe procedurat e regjistrimit të tyre në organin tatimor”;
- ✓ Udhëzim i Ministrit të Financave Nr.32, datë 31.12.2013, “Për tatimin e thjeshtuar mbifitim të biznesit të vogël”, i ndryshuar.
- ✓ Udhëzim i Ministrit të Financave Nr.26, datë 4.09.2008, “Për taksat kombëtare”, i ndryshuar.
- ✓ Udhëzim i Përbashkët (Ministri i Financave dhe Ministri i Drejtësisë) Nr. 655/1, datë 06.02.2007 “Për Përcaktimin e Uniformitetit të Standardeve Procedurale dhe të Raportimit të Sistemit të taksës Vendore”;
- ✓ Udhëzim i Ministrit të Zhvillimit Ekonomik, Turizmit, Tregtisë dhe Sipërmarrjes nr. 6756, datë 3.9.2015 “Për zbatimin e vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 54, datë 5.2.2014 “Për përcaktimin e kriterëve, të procedurës dhe të mënyrës së dhënies me qira, enfiteozë apo kontrata të tjera të pasurisë shtetërore”, i ndryshuar;
- ✓ Udhëzim nr.30, datë 27.12.2011, “Për Menaxhimin e Aktiveve në Njësitë e Sektorit Publik”, i ndryshuar;
- ✓ Udhëzuesi i Ministrit për Çështjet Vendore nr 541/1, date 31.12.2015 “Udhëzues për zbatimin e VKM nr.1108 dat.30.12.2015 “Për transferimin nga MBZHRAU tek bashkitë, të infrastrukturës së ujitjes dhe kullimit, të personelit dhe të aseteve të luajtshme dhe të paluajtshme”;
- ✓ Urdhëri i Ministrisë së Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, nr 189, datë 04.05.2018 “Për miratimin e çertifikatës shëndetësore veterinarë për mishin e kafshëve të llojit gjedh, të imta, derra të therura në thertore”
- ✓ Urdhëri i Ministrisë së Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, nr 190, datë 04.05.2018 “Për miratimin e çertifikatës shëndetësore veterinarë që shoqëron lëvizjen dhe transportin”
- ✓ Udhëzim i Përbashkët, i Ministrit të Financave dhe Ekonomisë dhe Ministri i Brendshëm Nr.17, datë 20.06.2022, “Për përcaktimin e Uniformitetit Minimal të Standardeve Procedurale për Mbledhjen e Detyrimeve të Taksave e Tarifave Vendore”.

TAKSA VENDORE

Kapitulli I:

Ky kapitull trajton taksat vendore në mënyrë nominale duke u nisur nga elementët:

- Lloji, baza e taksueshme, kategorizimet dhe nënkategorizimet, kështu e pagimit, koha e kryerjes së tyre, kushtet lehtësuese, strukturat përgjegjëse për vjeljen e detyrimeve dhe agjentët tatimorë.

1. Taksa mbi pasurinë e paluajtshme.

Taksës mbi pasurinë e paluajtshme i nënshtrohen të gjithë personat fizikë ose juridikë, vendas ose të huaj, pronarë apo përdorues të pasurive të mësipërme, në territorin e Republikës së Shqipërisë,



pavarsisht nga niveli i shfrytimit të këtyre pasurive. Bëjnë përjashtim rastet kur në ligj parashikohet ndryshe. Detyrimi për taksën mbi pasurinë e paluajtshme e ka, sipas rastit, pronari ose bashkëpronari, sipas pjesës që zotëron, apo përdoruesi i pronësisë së paluajtshme, për pasuritë që nuk janë të pajisura me dokumente pronësie.

“Pasuri e paluajtshme” janë, Trualli, Toka bujqësore dhe Ndërtesat mbi dhe nën tokë, sipas përcaktimit të Kodit Civil dhe legjislacionit për regjistrimin e pasurive të paluajtshme.

“Kadastra Fiskale” është regjistri qendror i bazës së të dhënave të pasurisë së paluajtshme që shërben për qëllime të administrimit të taksës mbi pasurinë e paluajtshme.

❖ Perkufizime:

Për qëllim të zbatimit të metodologjisë për përcaktimin e bazës së taksueshme të pasurisë së paluajtshme “ndërtesë”, termat e mëposhtëm kanë kuptimin si më poshtë vijon:

1. “Çmim vlerësues”, njësi matëse e vlerës për metër katror të sipërfaqes së ndërtimit të pasurisë së paluajtshme. Ky çmim mund të jetë çmimi i tregut ose çmimi i vlerësuar i përcaktuar në VKM Nr. 132/2018 e ndryshuar që mitaton metodologjinë.
2. “Ndarje/nënndarje zonale”, një rajon territorial brenda njësisë së vetëqeverisjes vendore me emër dhenëmër kadastral unik. Këto ndarje/nënndarje paraqiten në parcela tokësore me kufij të përcaktuar, që i ndajnë ato nga njëra-tjetra.
3. “Ndertesë”: është objekti/objektet e ndërtuara mbi/nën sipërfaqen e tokës ose të lidhura me tokën dhe që përfaqëson një strukturë ndërtimore me një ose më shumë njësi pronësore, e cila është objekt i taksës mbi ndërtesën sipas përcaktimit të dhënë në ligj.
4. “Ndertesë e papërfunduar”, objekti ndërtimor në tërësi ose/edhe ajo pjesë e ndërtesësekzistuese, për të cilin zhvilluesi është pajisur me leje ndërtimi, por që nuk ka arritur ta përfundojë atë sipas afatit të përcaktuar në aktin e miratimit të kërkesës për leje ndërtimi.
5. “Njësi pronësore”, ndërtesa ose pjesë e saj, e cila është në pronësi/përdorim të individit, të njëpersonit fizik apo të një personi juridik, dhe që është e ndarë ligjërisht nga pronat e tjera të pasurisë së paluajtshme “ndërtesë”. Njësi pronësore mund të përdoret për qëllim banimi ose/edhe për qëllim veprimtarie ekonomike etj.
6. “Ndarje e njësisë pronësore për banim”, pjesa e njësisë pronësore që përdoret për qëllim banimi.
7. “Ndarje e njësisë pronësore për veprimtari ekonomike”, pjesa e njësisë pronësore që përdoret për qëllim veprimtarie ekonomike.
8. “Përdorues”, individ, personi fizik ose personi juridik, që ka në përdorim ndërtesën/ njësinë pronësore për qëllime banimi, veprimtarie ekonomike apo për veprimtari joekonomike, pavarsisht nga fakti nëse kjo ndërtesë/njësi pronësore ka titull pronësie ose jo.
9. “Regjistër qendror i bazës së të dhënave të pasurisë së paluajtshme” (Kadastra fiskale), sistemi qendror i bazës së të dhënave, i cili shërben për hedhjen, përpunimin, korrektimin e të dhënave, të cilat lidhen me pasurinë e paluajtshme dhe që shërbejnë për efekt të llogaritjes së shumës së taksës së pasurisë së paluajtshme për t’u paguar nga çdo taksapagues. Ky regjistër ofron informacion për përdoruesit.



10. "Taksapagues", çdo individ, person fizik ose juridik, vendës ose i huaj, pronar apo përdorues i pasurive të paluajtshme në territorin e Republikës së Shqipërisë, pavarësisht nga niveli i shfrytëzimit të këtyre ndërtesave. Detyrimin për pagimin e taksës mbi pasurinë e paluajtshme "ndërtesë" e kanë, sipas rastit, pronari ose bashkëpronari, sipas pjesës që zotëron, apo përdoruesi i pasurisë së paluajtshme, për pasuritë që nuk janë të pajisura me dokumente të pronësisë, personat që kanë aplikuar për legalizim të ndërtesës, zhvilluesit, të cilët nuk arrijnë të mbyllin ndërtimin sipas lejes përkatëse të lëshuar nga njësia e vetëqeverisjes vendore.
11. "Vlerë e pasurisë", vlera aktuale e pasurisë së paluajtshme ndërtesë/njësi pronësore e njohur me dokumente ligjore ose vlera e përcaktuar me një nga metodat e përshkruara në VKM Nr. 132/2018 e ndryshuar që mitaton metodologjinë. Vlera e pasurisë është baza e taksueshme mbi të cilën aplikohet shkalla e taksës së pasurisë së paluajtshme ndërtesë/njësi pronësore. Vlera e pasurisë llogaritet si shumëzim i çmimit për metër katror me sipërfaqen e ndërtesës/njesisë pronësore.
12. "Veprimtari ekonomike", çdo veprimtari e kryer nga prodhuesit, tregtarët, personat që furnizojnë mallra dhe shërbime, përfshirë veprimtaritë nxjerrëse, industriale, tregtare, të shërbimit, bujqësore dheveprimtaritë profesionale. Veprimtari ekonomike konsiderohet, gjithashtu, shfrytëzimi i pasurisë së trupëzuar ose të patrupëzuar, me qëllim realizimin e të ardhurave me karakter të vazhdueshëm.

a) Taksa mbi ndërtesat.

(VKM Nr. 132/2018 është ndryshuar me VKM nr. 168, datë 27.3.2019, VKM Nr. 144, datë 13.2.2020, dhe VKM Nr. 457, datë 26.7.2023.)

1. Taksës mbi ndërtesat i nënshtrohen individët, personat fizikë ose juridikë, vendas apo të huaj, pronarë ose përdorues të pasurive të paluajtshme në territorin e Republikës së Shqipërisë, pavarësisht nga niveli i shfrytëzimit të këtyre ndërtesave, përveç rasteve kur në 9632, datë 30.10.2006 "Për sistemin e taksave vendore"i ndryshuar, përcaktohet ndryshe.
2. Taksës mbi ndërtesat i nënshtrohen personat që kanë aplikuar për legalizim të ndërtesës, sipas ligjit "Për legalizimin, urbanizimin dhe integrimin e ndërtimeve pa leje".
3. Taksës mbi ndërtesat i nënshtrohen zhvilluesit, të cilët nuk arrijnë të mbyllin ndërtimin sipas lejes përkatëse, të lëshuar nga autoriteti i planifikimit. Afati i përlllogaritjes së taksës fillon nga momenti i mbarimit të afatit kohor të përcaktuar në afatin e miratimit të kërkesës për leje ndërtimi.
4. Detyrimi për taksën mbi ndërtesat llogaritet si shumëzim i bazës së taksës me shkallën e taksës mbi ndërtesën.
5. Taksa vendore mbi pasurinë e paluajtshme-ndërtesë llogaritet si detyrim vjetor i taksapaguesit. Pagesa e taksës bëhet çdo muaj apo për periudha më të gjata, në varësi të kategorisë së taksapaguesit, sipas përcaktimeve në vendimin e Këshillit të Ministrave.

Baza e taksës.



Baza e taksës mbi ndërtesat është vlera e ndërtesës, që llogaritet në përputhje me metodologjinë dhe procedurat e përcaktuara me vendim të Këshillit të Ministrave. Këshilli i Ministrave, në bazë të vjetërsisë së ndërtesës, mund të specifikojë nënkategori përkatëse.

Shkalla e taksës.

Shkalla e taksës mbi ndërtesat, e cila alpikohet si përqindje e bazës së taksës, është si mëposhtë:

- a) **0.05%**, për ndërtesën që përdoret, shfrytëzohet për banim;
- b) **0.2%**, për ndërtesën që përdoret, shfrytëzohet për veprimtari ekonomike;
- c) **30%** e shkallës së taksës përkatëse, për të gjithë sipërfaqen ndërtimore, për të cilën zhvilluesi është paisur me leje ndërtimi dhe nuk ka arritur ta përfundojë atë, sipas afatit të përcaktuar në aktin e miratuar të kërkesës për leje ndërtimi.

Nënkategori specifike ndërtesash dhe qëllimi i përdorimit

Nënkategorizimi i ndërtesave/njësi pronësore që nuk përdoren për banim, sipas qëllimit të përdorimit dhe të shfrytëzimit të tyre, përcaktohen në aneksin 2, të VKM Nr. 132/2018 e ndryshuar. Nënkategoritë e ndërtesave/njësi pronësore, që shfrytëzohen për banim/strehim, jepen si më poshtë:

- a) Ndërtesa e cila u shërben njerëzve për nevoja themelore banimi, duke përfshirë shtëpitë, apartamentet, banesat dhe ndërtesat e ngjashme;
- b) Garazhet e mbyllura;
- c) Bodrumet;
- d) Çdo ndërtesë tjetër e ngjashme, mbi apo nën tokë, që nuk përdoret apo shfrytëzohet për qëllime të tjera veç atij të banimit.

Në zbatim të ligjit nr. 115/2014, edhe në mbështetje të nenit 2 pika 3 e VKM 132 të ndryshuar nga data 01.01.2025 aplikohet nëndarje zonale ku përfshihen të gjitha Njësitë Administrative, për zbatimin e niveleve të shkallës së taksës minus 20 (njëzetë) për qind për çdo lloj ndërtesë dhe ndarje/nëndarje zonale Periferi (jashtë qendrës së qytetit), për zbatimin e niveleve të shkallës së taksës minus 10 (dhjetë) për qind (përveç zonës së qytetit e cila përfshin Fshatrat; Belsh Qëndër, Belsh, Trojas, Gradisht).

ANEKSI 1

ÇMIMET MESATARE REFERUESE PËR METËR KATROR SIPËRFAQE NDËRTIMI PËR VLERËSIMIN E VLERËS SË TAKSUESHME PËR BANESAT

(zëvendësuar me VKM nr. 168, datë 27.2.2019, nr. 457, datë 26.7.2023)

Çmimet mesatare referuese të shitblerjes së:

- a). ndërtesave që përdoren për qëllim banimi, sipas qyteteve, për çdo bashki, sipas qarqeve.
- a.1). Çmimet mesatare referuese të shitblerjes së ndërtesave që përdoren për qëllim banimi, sipas qyteteve, për çdo bashki, sipas qarqeve (me përjashtim të Bashkisë Tiranë) sipas tabelës më poshtë:

Tabela 1

Nr.	Qarku	Nr.r. bashki	Bashkia	Nr.r. qytete	Nr.r.qytet i qarkut	Qyteti	Lek/m ² sipërfaqe shfrytëzimi.
-----	-------	--------------	---------	--------------	---------------------	--------	---



4	Elbasan	14	Belsh	15	2	Belsh	35 000,00 lekë .
---	---------	----	-------	----	---	-------	------------------

Ndarje/nënndarje zonale; (neni 2 pika 3 i VKM 132/2018, Nënndarja zonale/nënzonale brenda territorit të njësisë së vetëqeverisjes).

Njësia Belsh ndahet në: Belsh Qytet dhe Periferi sipas tabelës më poshtë:

Tabela 2.

Nr.	BASHKIA	Qendra e Bashkisë	Njësitë administrative përbërëse	Qytetet dhe fshatrat në përbërje të tyre
1.	BELSH	Qyteti Belsh	Belsh	Fshatrat: Belsh Qëndër, Belsh, Trojas, Gradisht.
2.		Periferi	Periferi	Fshatrat: Çepe, Dushk, Stanaj, Shkozë, Qafë Shkallë, Seferan, Shkëndi, Marinëz, Shtirh.

Shënim: Ndarje/nënndarje zonale për Njësinë Administrative Belsh bëhet për arsye se fshatrat e quajtura Periferi ndodhen në një distancë të konsiderueshme nga qendra dhe për këtë arsye nuk mundë të trajtohen me të njëjtin nivel të shkallës së taksës me Qendrën.

Nr. Kadastral për çdo fshatë që do të njihet si periferi janë si mëposhtë:

- Çepë, zona kadastrale 1367;
- Dushk, zona kadastrale 1581;
- Stanaj, zona kadastrale 3507;
- Shkozë, zona kadastrale 3393;
- Qafshkall, zona kadastrale 3082;
- Seferan, zona kadastrale 3272;
- Shkëndi, zona kadastrale 3387;
- Marinëz, zona kadastrale 2598;
- Shtith, zona kadastrale 3424;

ANEKSI 2

ÇMIMET MESATARE REFERUESE PËR METËR KATROR SIPËRFAQE NDËRTIMI PËR VLERËSIMIN E VLERËS SË TAKSUESHME PËR NDËRTIME DHE AMBIENTE JOBANIMI

(zëvendësuar me VKM nr. 168, datë 27.2.2019, ndryshuar shkronjat "c" dhe "ç" me vendimin nr. 144, datë 13.2.2020, nr. 457, datë 26.7.2023)

a). Çmimi për metër katror sipërfaqe ndërtimi për veprimtari ekonomike tregtimi shërbimi është 1.5 (një pikë pesë) here më i lartë se çmimi i sipërfaqeve të banimit sipas qyteteve. Në këtë kategori përfshihen edhe njësitë tregtare, ku njëkohësisht realizohen edhe procese të përziera prodhimi, tregtimi apo shërbimi me pakicë. Në zonat që përfshihen në Bashkinë Tiranë ky koeficient është 2 (dy) herë më i lartë.

b). Çmimi për metër katror sipërfaqe ndërtimi për parkim të mbuluar dhe bodrume është 70 (shtatëdhjetë) për qind e çmimit të sipërfaqeve të apartamenteve të banimit sipas qyteteve.

c). Çmimi për metër katror sipërfaqe ndërtimi për ambiente parkim i hapur, pishinë e hapur, ambiente sportive të hapura, të tilla si: fusha futbollit, minifutbollit, basketbollit, volejbollit, tenisi, golfi, pista për gara të ndryshme sportive të atletikës, motorike, garave me kuaj e të tjera të ngjashme me to; porte dhe aeroporte të çdo kategorie, për të gjithë sipërfaqen e shtrirë që ato



zënë, është 30 (tridhjetë) % e çmimit të sipërfaqeve të apartamenteve të banimit sipas qyteteve, ose sipas njësive administrative për Bashkinë Tiranë.

ç). Çmimi për metër katror sipërfaqe ndërtimi të destinuara për veprimtari industriale, të tilla si: prodhim, përpunim apo magazinim të lëndëve të para, të gjysmëprodukteve apo të produkteve të gatshme industriale, si: fabrika, magazina, depo, silos, magazina frigoriferike të produkteve ushqimore (përjashtuar ato të njësive të tregtimit dhe të shërbimit), si dhe objektet e tjera të ngjashme me to, është 50 (pesëdhjetë) % e çmimit të sipërfaqeve të banesave të zonës përkatëse, sipas qyteteve ose sipas njësive administrative për Bashkinë Tiranë.

Në këtë kategori përfshihen dhe ndërtesat që shërbejnë për veprimtari arsimore jopublike të çdo niveli, si dhe ambientet sportive të mbyllura, përfshirë dhe pishinat e mbyllura.

d). Çmimi për metër katror sipërfaqe ndërtimi që përdoren për bujqësi dhe blegtori, apo veprimtari mbështetëse, si: grumbullim, magazinim dhe ruajtje të produkteve bujqësore dhe blegtorale, është 30 (tridhjetë) për qind e çmimit të sipërfaqeve të banesave të zonës përkatëse, me përjashtim të përpunimit ushqimor.

dh). Çmimi për metër katror sipërfaqe ndërtimore për ndërtimet e reja regjistruar sipas lejes së përdorimit në ASHK, pas hyrjes në fuqi të këtij vendimi, do të indeksohet me koeficientin 0.2 (zero pikë dy) herë më i lartë se çmimi i sipërfaqes së apartamentit të banimit sipas listës së përcaktuar aneksin I që i bashkëlidhet këtij vendimi, për 5 vitet e para pas regjistrimit të lejes së përdorimit në ASHK.

Taksa vendore mbi pasurinë e paluajtshme “ndërtesa” llogaritet si detyrim vjetor i taksapaguesit.

Shënim: *Perfitim ulje për Taksa mbi ndërtesën me 5% të gjithë bizneset që paguajn brenda datës 30 prill.*

Struktura e caktuar për vjeljen e kësaj takse është:

- ✓ Sektori i të Ardhurave Vendore për Bashkinë Belsh ngarkohet për vjeljen e taksave të biznesit të madh dhe të vogël (*pagesa kryhet pranë arkës së bashkisë dhe në çdo bankë të nivelit të dytë*).
- ✓ Për subjektet familje pagesa e taksës mund të bëhet çdo muaj e ndarë në 12-këste, por në mungesë të agjentit të taksave parashikuar sipas ligjit, kjo taksë do të bëhet vjetore .
- ✓ Për subjektet familje **afati i pagesës është data 31.12.2026**, (*kjo pages bëhet pranë zyrës së Tatim Taksave Bashkia Belsh dhe në zyrat e Njësive Administrative Kajan, Grekan, Fierzë, Rrasë*).
- ✓ Afati i njoftimit të tatimpaguesit do të jetë deri në datën **31.03.2026**.
- ✓ Afati i pagesës së taksës së ndërtesës nga subjektet që ushtrojnë aktivitet ekonomik do të jetë data **30.06.2026**.
- ✓ Për mospagesë në afatin e caktuar do të zbatohen procedurat për marrjen e masave të detyrimit tatimor sipas ligjit nr 9920, date 19.05.2008, “Per Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë” dhe do të aplikohet gjobë në masën 1.8% çdo muaj vonesë, por jo më shumë se 12 muaj.

Përjashtohen nga taksa mbi ndërtesat:

a) pronat e shtetit dhe të njësive të qeverisjes vendore, që përdoren për qëllime jofitimprurëse;



- b) pasuritë në pronësi të shtetit, të kaluara me vendim të Këshillit të Ministrave, nën administrimin e shoqërive publike shtetërore;
- c) ndërtesat e banimit, që shfrytëzohen nga qiramarrësi me qira të paliberalizuara;
- ç) banesat sociale në pronësi të bashkive;
- d) pasuritë e paluajtshme-ndërtesa, pronë e subjekteve juridike ose fizike, që në bazë të marrëveshjeve me bashkitë përdoren nga këto të fundit si banesa sociale;
- dh) ndërtesat që përdoren nga komunitetet fetare, në funksion të veprimtarisë së tyre;
- e) strukturat akomoduese "Hotel/Resort me katër dhe pesë yje, status special", sipas përcaktimit në legjislacionin e fushës së turizmit dhe që janë mbajtës të një marke tregtare të regjistruar dhe njohur ndërkombëtarisht "brand name";
- ë) ndërtesat e banimit, të deklaruara si vendbanim nga kryefamiljarët që përfitojnë pension pleqërie/pension social, kur familja e tyre përbëhet vetëm nga pensionistë, ose dhe me persona në ngarkim të tyre, që janë të pa aftë për punë;
- f) ndërtesat e banimit të kryefamiljarëve që trajtohen me ndihmë ekonomike;
- g) ndërtesat kulturore, nën mbrojtje të përkohshme ose të përhershme, për kohën në të cilën deklarohet mbrojtja, sipas legjislacionit në fuqi për monumentet e kulturës dhe/ose trashëgiminë kulturore, të cilat përdoren vetëm për qëllime jofitimprurëse.

b) Taksa mbi tokën bujqësore.

Përkufizimi: "Tokë bujqësore" është toka e përcaktuar si e tillë në regjistrin e zyrave të regjistrimit të pasurisë.

Baza e taksës mbi tokën bujqësore është sipërfaqja e tokës bujqësore, në hektar, në pronësi, në përdorim të taksapaguesit. Sipërfaqja e tokës në pronësi përcaktohet sipas dokumentave që e vërtetojnë atë. Në rast të mungesës së dokumentacionit të pronësisë, përdoruesi i tokës bujqësore bën një vetëdeklarim të sipërfaqes së tokës bujqësore, pranë Bashkisë (Njësis Administrative) ku ndodhet toka.

- ✓ Niveli i taksës caktohet në lekë për hektar. Detyrimi i takës llogaritet si shumëzim i nivelit të taksës me bazën e tatueshme. Nivelet treguese të taksës, për çdo kategori minimale të bazës së taksës, jepen sipas tabelës më poshtë:

Nr	Klasifikimi sipas kategorive të tokës	Vlera 100%/Hektar	Vlera 70%/Hektar
1.	Kategoria I	4200 Lekë	2940 Lekë
2.	Kategoria II	3500 Lekë	2450 Lekë
3.	Kategoria III	2800 Lekë	1960 Lekë
4.	Kategoria IV	2300 Lekë	1610 Lekë
5.	Kategoria V	1900 Lekë	1330 Lekë
6.	Kategoria VI	1600 Lekë	1120 Lekë
7.	Kategoria VII	1400 Lekë	980 Lekë



- ✓ Afati i njoftimit të tatimpaguesit do të jetë deri në datën **31.03.2026**.
- ✓ Afati për pagesën e taksës bujqësore është data **31.12.2026**.
- ✓ Ngarkohet Sektori Bujqësis-Blegtorisë, Pyjeve dhe Kullotave, për vlerësimin e kategorisë së tokës si dhe saktësimin dhe verifikimin e periudhës së mbjelljes me kultura drufrutore dhe vreshtari, për çdo fermer/fermë.
- ✓ Për mospagesë në afatin e caktuar do të zbatohen procedurat për marrjen e masave të detyrimit tatimor sipas ligjit nr 9920, date 19.05.2008. "Per Procedurat Tatimore ne Republikën e Shqipërisë" dhe do të aplikohet gjobë në masën 1.8% çdo muaj vonesë, por jo më shumë se 12 muaj.
- ✓ Strukturat e caktuara për mbledhjen e taksës së tokës janë Zyra e Tatim-Taksave pranë Bashkisë Belsh dhe Njësit Administrative (*Kajan, Grekan, Fierzë, Rrasë*);

Perjashtohen nga taksa e tokës:

- ✓ *Përjashtohen nga taksa tokat bujqësore, që mbillen me kultura drufrutorë dhe vreshtari për 5 (pesë) vitet e para nga çasti i mbjelljes.*
- ✓ *Përjashtohen nga taksa e tokës bujqësore, invalidët e luftës dhe të punës që e vërtetojnë me statusin e invalidit, të semuret tetraplegjikë e paraplegjikë, të verbërit që vërtetonin me statusin e verbëris, vetëm për sipërfaqen e tokës që ka në pronësi vetë personi sipas Aktit të Marrjes së Tokës në Pronësi.*

c) Taksa mbi Truallin.

(Shtuar me ligjin nr.142/2015, datë 17.12.2015, ndryshuar referenca e aneksit në pikat 1 dhe 2 me ligjin nr.95/2018, datë 3.12.2018).

- ✓ Baza e taksës mbi truallin është sipërfaqja e truallit, në metër katror, në pronësi apo përdorim të taksapaguesit. Sipërfaqja e truallit në pronësi përcaktohet sipas dokumenteve që e vërtetojnë atë. Në rast të mungesës së dokumentacionit të pronësisë, përdoruesi i truallit bën një vetëdeklarim të sipërfaqes së truallit në përdorim, pranë Bashkisë (*Njësisë Administrative*)ku ndodhet trualli.
- ✓ Ngarkohet Sektori Bujqësis-Blegtorisë, Pyjeve dhe Kullotave, për vlerësimin e kategorisë së taksës mbi.
- ✓ Niveli i taksës caktohet në lekë për metër katror. Detyrimi i taksës llogaritet si shumëzim i nivelit të taksës me bazën e tatueshme.

Nniveli tregues i taksës vendore mbi pasurinë e paluajtshme Truall(*jo hapsir publike*), sipas tabelës:

Kategoritë dhe nën kategoritë	Për qëllime banimi nga individët ose troje të tjera me destinacion jo ekonomik	Për qëllime biznesi
--------------------------------------	--	---------------------



Lekë/m ² /vit	0,14 lekë/m ²	12 lekë/m ²
--------------------------	--------------------------	------------------------

Shënim: *Perfitim ulje për Taksa mbi Truallin me 5% të gjithë bizneset që paguajn brenda datës 30 prill.*

- ✓ Struktura e ngarkuar për vjeljen e taksës për truallin është Zyra e Tatim-Taksave pranë Bashkisë Belsh dhe Njësitë Administrative (*Kajan, Grekan, Fierzë, Rrasë*).
- ✓ Afati për pagesën e taksës së truallit, (për qëllime banimi nga individët ose troje të tjera me destinacion jo ekonomik) është data **31.12.2026**.
- ✓ Afati i njoftimit të tatimpaguesit do të jetë deri në datën **31.03.2026**.
- ✓ Afati për pagesën e taksës së truallit, (për qëllime biznesi) është data **30.06.2026**.
- ✓ Për mospagesë në afatin e caktuar do të zbatohen procedurat për marrjen e masave të detyrimit tatimor sipas ligjit nr 9920, date 19.05.2008, “Per Procedurat Tatimore ne Republiken e Shqipërisë” dhe do të aplikohet gjobë në masën 1.8% çdo muaj vonesë, por jo më shumë se 12 muaj.

2. Taksa e fjetjes në hotel;

(Ndryshuar me ligjin nr.142/2015, datë 17.12.2015)

- ✓ Me “hotel” kuptohet çdo veprimtari që jep strehim kundrejt pagesës dhe përfshin emërtimet: kamping, bujtinë, hotel, motel, stabiliment turistik, pensjon, shtëpi pritje, turizëm familjar dhe çdo objekt tjetër që përdoret për këtë qëllim.
- ✓ Baza e taksës së fjetjes në hotel është numri i netëve të qëndruara në hotel.
- ✓ Taksa vendore e fjetjes në hotel në Bashkin Belsh, sipas tabelës.

Nr.	Baza e taksës	Niveli Lekë për natë fjetje për person
1.	Hotel me 4 ose 5 yje	105
2.	Hotele nën 4 yje ,fjetinë,motel dhe çdo njësi tjetër akomoduese të ngjashme me to, sipas përcaktimit të ligjit për turizmin	35

- ✓ Detyrimi për taksën llogaritet si shumëzim i nivelit të taksës së vendosur nga bashkia, për natë qëndrim, me numrin e netëve të qëndrimit në hotel.
- ✓ Detyrimi për taksën i takon klientit që strehohet në hotel, detyrim i cili mbahet nga hoteli për llogari të bashkisë, në territorin e së cilës ndodhet hoteli. Në faturën e hotelit shënohet çmimi i fjetjes dhe mbi të vlera e taksës.
- ✓ Derdhja e të ardhurave për këtë taksë nga hoteli në favor të bashkisë bëhet brenda datës 5 (pesë) të muajit pasardhës.



- ✓ Subjektet duhet të bëjnë vetëdeklarimin e numrit të netëve të qëndrimit në hotel shoqëruar me dokumentacion justifikues.
- ✓ Në rastet kur subjektet nuk mbajnë regjistër të klientëve që flejnë në hotel, administratës i lind e drejta të bëjë vlersimin.
- ✓ Struktura e ngarkuar për vjeljen e kësaj takse është Zyra e Tatim-Taksave, pranë Bashkisë Belsh.
- ✓ Për mospagesë në afatin e caktuar do të zbatohen procedurat për marrjen e masave të detyrimit tatimor sipas ligjit nr 9920, date 19.05.2008, "Per Procedurat Tatimore ne Republikën e Shqipërisë" dhe do të aplikohet gjobë në masën 1.8% çdo muaj vonesë, por jo më shumë se 12 muaj.

3. Taksa e ndikimit në infrastrukturë;

(Ndryshuar me ligjin nr.10073, datë 9.2.2009, shtuar pika 2/1 me ligjin nr.10146, datë 28.9.2009, ndryshuar plotësisht me ligjin nr.142/2015, datë 17.12.2015, shtuar pika 7 me ligjin nr.106, datë 30.11.2017, shtuar pika 8 me ligjin nr.41/2018, datë 9.7.2018, ndryshuar pika 1 dhe 2 me ligjin nr.95/2018, datë 3.12.2018, shtuar pika 9 me aktin normativ nr.3, datë 2.10.2019, shfuqizuar fjala e dytë e shkronjës "c" të pikës 3 me ligjin nr.98/2020, datë 23.07.2020, hequr fjala në pikën 9 me ligjin nr. 122/2020, datë 15.10.2020; hequr fjalë shkronja "a", shtuar "a/1" në pikën 3 me ligjin nr.67/2023, datë 21.7.2023)

- ✓ Baza e taksës është vlera në lekë e investimit të ri që kërkohet të kryhet sipas preventivit, ose vlera në lekë e çmimit të shitjes për metër katror të investimit të ri. Klasifikimi si investim i ri përcaktohet në përputhje me legjislacionin në fuqi për dhënien e lejes së ndërtimit.
- ✓ Në rastin e ndërtimeve, niveli i taksës shprehet si përqindje e vlerës së investimit dhe:
 - a) Për ndërtime që destinohen për përdorim në sektorin e turizmit, të industrisë, të ndërtimeve individuale për qëllime të përdorimit vetiak nga individët, të ndërtuara nga vetë individi apo me sipërmarrës, si dhe të ndërtimeve për qëllime publike, taksa e ndikimit në infrastrukturë është 1 deri në 3 për qind e vlerës së investimit.
 - b) Për projekte të infrastrukturës, për ndërtimin e rrugëve kombëtare, të porteve, aeroporteve, tuneleve, digave, ndërtimit të infrastrukturës në energji, përfshirë makineritë dhe pajisjet për këto projekte, taksa e ndikimit në infrastrukturë të ndërtimeve të reja është 0.1 (zero pikë një) për qind e vlerës së investimit, por jo më pak se kostoja e rehabilitimit të infrastrukturës së dëmtuar, kur kjo kosto nuk është përfshirë në preventivin e investimit.
 - c) Për ndërtesat, të cilat janë në proces legalizimi, taksa e ndikimit në infrastrukturë e ndërtimeve të reja është 0.5 (zero pikë pesë) për qind e vlerës së investimit

	Kategoritë e objekteve	Vlera e taksës
1.	Objekte banimi	1 %
2.	Objekte shërbimi dhe industriale	3 %
3.	Objekte që janë në proces legalizimi	0.5 %



Baza e taksës: niveli i taksës shprehet si përqindje e vlerës së investimit.

Detyrimi i pagesës: Detyrimi për taksën i takon investitorit.

Përlllogaritja e detyrimit nga taksa do të bëhet, duke aplikuar përqindjet përkatëse sipas kategorisë, ndaj vlerës së investimit për sipërfaqe respektive.

Struktura e caktuar për vjeljen e kësaj takse është Drejtoria e Planifikimit, Kontrollit, Mjedisit dhe Pronave Publike.

a) Kontributi i sektorit privat në krijimin e fondit publik të banesave sociale.

(Sipas përcaktimeve në Ligjin Nr. 22/2018 "Për strehimin social" Sipas përcaktimeve në Ligjin Nr 107/2014 "Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit, VKM Nr.325, datë 29.05.2024)

- ✓ Çdo subjekt privat që, pas hyrjes në fuqi të këtij ligji, aplikon për leje zhvillimi dhe ndërtimi për ndërtime me sipërfaqe ndërtimore banimi mbi 2 000 metra katrorë, siguron kalimin pa shpërblim 3 (tre) për qind të sipërfaqes funksionale, me kushtet e një strehimi të përshtatshëm, në favor të fondit publik të banesave sociale. Kjo sipërfaqe, në rast pamundësie për t'u dhënë në sipërfaqen ndërtimore të banimit që ndërtohet, mund të jepet në një sipërfaqe tjetër ndërtimore banimi. Kontrata që nënshkruhet mes palëve për kalimin e sipërfaqes ndërtimore në favor të fondit publik të banesave sociale, regjistrohet në Zyrën e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme.
- ✓ Në kontratën paraprake midis njësisë së vetëqeverisjes vendore dhe subjektit privat, që paraqet kërkesën për leje zhvillimi dhe ndërtimi, përcaktohet mënyra e përfitimit të fondit publik të banesave sociale, referuar sipërfaqeve me metër katror apo e dhënë ajo në vlerë leku, sipas çmimit referues të pasurisë së paluajtshme "ndërtesa" për zonën ku po ndërtohet, bazuar në sipërfaqen e përgjithshme funksionale të objektit të banimit në ndërtim.
- ✓ Nëse një subjekt që aplikon për leje zhvillimore për ndërtim banese, për efekt përfitimi, kërkon rritje të intensitetit të ndërtimit, në përputhje me standardet e miratuara në planin vendordhe vetëm atëherë kur bashkia ka miratuar një plan vendor, atij mund t'i akordohet shtesa në intensitet përkundrejt përfitimit të një sipërfaqeje ndërtimi në favor të bashkisë, për strehim social, sipas parashikimeve të legjislacionit në fuqi për planifikimin dhe zhvillimin e territorit.

Kushte lehtësuese: Në rast të zbatimit të një projekti të veçantë për eficientë e energjisë urbane, projekti verifikohet dhe nëse është zbatuar me përpikmëri, atëherë subjektit i rimburohet taksa e paguar mbi nivelin minimal të përcaktuar me ligj.

- Struktura e caktuar për vjeljen e kësaj takse është Drejtoria e Planifikimit, Kontrollit, Mjedisit dhe Pronave Publike.

Perjashtohen nga taksa e ndikimit infrastrukturë:

- ✓ Përjashtohen nga pagesa e kësaj takse investimet e kryera për ndërtimin e strukturave akomoduese "Hotel/Resort me pesë yje, status special", sipas përcaktimit në legjislacionin e fushës së turizmit dhe që janë mbajtës të një marke tregtare të regjistruar dhe njohur ndërkombëtarisht "brand name".



- ✓ Përjashtohen nga pagesa e kësaj takse edhe investimet e subjekteve, të cilat zhvillojnë veprimtari pritëse të certifikuar si “agroturizëm”, sipas legjislacionit në fuqi në fushën e turizmit.
- ✓ Përjashtohen nga pagesa e kësaj takse investimet për rindërtimin, riparimin apo restaurimin e ndërtesave të destinuara për qëllime banimi, të dëmtuara si pasojë e fatkeqësive natyrore, sipas përkufizimit të dhënë në legjislacionin në fuqi për mbrojtjen civile. Kushtet, rregullat dhe dokumentet që shoqërojnë kërkesën për përjashtimin nga detyrimi për pagesën e taksës së ndikimit në infrastrukturë, sipas kësaj pike, përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave.
- ✓ Nga pagesa e kësaj takse përjashtohen edhe investimet në kuadër të programeve të rindërtimit, sipas dispozitave të ligjit, për përballimin e pasojave të fatkeqësisë natyrore

b) Për autorizime punimesh.

Taksa e ndikimit në infrastrukturë për punime me autorizim dhe që sipas ligjit nuk kanë të nevojshme marrjen e lejes së ndërtimit:

	Lloji i punimeve	Niveli
a.	Tarifë për aplikimin për pajisje me leje Zhvillimi të lëshuara nga Drejtoria e Planifikimit, Kontrollit, Mjedisit dhe Pronave Publike.	5.000 lekë/rast.
b.	Tarifë për aplikimin për pajisje me deklarat paraprake punimesh e të lëshuara nga Drejtoria e Planifikimit, Kontrollit, Mjedisit dhe Pronave Publike.	5.000 lekë/rast.
c.	Tarifë për Çertifikatën e Përdorimit për objektet të pajisura me Leje Ndërtimi: <ul style="list-style-type: none"> - Për objekte banimi(mbi sip. ndërtimi totale) - Për objekte shërbimi, tregtimi, biznese (mbi sip. ndërtimi totale) 	50 lekë/m ² 100 lekë/m ²
d.	Taksë për leje Ndërtimi për ndryshimin e Aktiviteteve/Funksioneve	150 lekë/m ²

- Struktura e caktuar për vjeljen e kësaj takse është Drejtoria e Planifikimit, Kontrollit, Mjedisit dhe Pronave Publike.

c) Garanci financiare për subjektet fizike/juridike, kërkuar i lejes për ndërtimin, riparimin, restaurimin apo shembjen e objektit:

- ✓ Garancia financiare: Në mbështetje të pikës 10 të VKM-se Nr. 575, datë 24.6.2015 “Për miratimin e kërkesave për menaxhimin e mbetjeve inerte”, subjekti fizik/juridik, kërkuar i lejes për ndërtimin, riparimin, restaurimin apo shembjen e objektit, përpara marrjes së lejes së ndërtimit duhet të depozitojë një garanci financiare për llogari të NJQV-së, e cila



nuk do të jetë më e vogël se 3% e vlerës së strukturës së objektit dhe përcaktohet me vendim të këshillit të NJQV-së.

- ✓ Njësitë e qeverisjes vendore, më konkretisht Drejtoria e Planifikimit, Kontrollit, Mjedisit dhe Pronave Publike, në dokumentacionin e lëshimit të lejes për projektin e ndërtimit, riparimit, restaurimit apo shembjes, përcaktojnë se personi fizik ose juridik, të cilit i është dhënë leja për realizimin e projektit, duhet të provojë me dokumentacionin e nevojshëm përmbushjen e kërkesave sipas VKM Nr. 575, brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga data e përfundimit të projektit të ndërtimit, riparimit, restaurimit apo prishjes së objektit, i cili krijon mbetje inerte.
- ✓ Garancia financiare i kthehet subjektit fizik/juridik pa interes nga Bashkia, e cila ka lëshuar lejen e ndërtimit, pasi të provojë se mbetjet inerte janë dorëzuar, sipas pikave 4, 5 dhe 6, të VKM Nr. 575 në landfillin ose në venddepozitim të përkohshëm të përcaktuar nga Bashkia. Në rast të mospërmbushjes së kushteve të sipërpërmendura, Bashkia konfiskon garancinë financiare.
- Struktura e ngarkuar për llogaritjen e pagesës së garancisë financiare është Drejtoria e Planifikimit, Kontrollit, Mjedisit dhe Pronave Publike.
- Struktura e caktuar për vjeljen e kësaj takse është Drejtoria e Planifikimit, Kontrollit, Mjedisit dhe Pronave Publike.

4. Taksa mbi kalimin e së drejtës së pronësisë mbi pasuritë e paluajtshme;

Nivelet e taksës vendore për kalimin e të drejtës së pronësisë mbi pronën, sipas tabelës:

Nr.	Kategoritë e ndërtesave	Lekë/m ²
1	Ndërtesë Banimi	100
2	Ndërtesat e tjera për tregti dhe shërbime përfshi dhe zyra	300
3	Ndërtesa të tjera	200

- ✓ Taksa mbi kalimin e të drejtës së pronësisë për pasuritë e paluajtshme vendoset për ndërtesat dhe të gjitha pasuritë e paluajtshme në çastin e kalimit të së drejtës së pronësisë mbi to. Taksa paguhet nga personi, që kalon të drejtën e pronësisë mbi pasurinë e paluajtshme, para kryerjes së regjistrimit, në përputhje me aktet ligjore në fuqi.
- ✓ Baza e taksës mbi kalimin e të drejtës së pronësisë për ndërtesat është sipërfaqja e ndërtimit, pronësia e së cilës transferohet. Kategoritë e ndërtesave, për efekt të bazës së taksueshme, jepen në aneksin nr.3 që i bashkëlidhet këtij ligji. Niveli i taksës caktohet në lekë për metër katror të bazës së taksës. Detyrimi tatimor llogaritet si shumëzim i nivelit të taksës me bazën e tij.



- ✓ Baza e taksës për kalimin e të drejtës së pronësisë për pasuritë e tjera të paluajtshme është vlera e shitjes së tyre. Niveli i taksës caktohet në përqindje dhe niveli tregues i taksës është 2 për qind. Detyrimi tatimor llogaritet si shumëzim i nivelit të taksës me bazën e tij.
- Vjelja e kësaj takse bëhet nga zyrat e regjistrimit të pasurive të paluajtshme, të cilat, në rolin e agjentit të taksave, përfitojnë 3 për qind të shumës së arkëtuar dhe diferencën e derdhit për llogari të buxhetit përkatës të bashkisë, në territorin e së cilës ndodhet pasuria, jo më vonë se data 30 e muajit pasardhës.

1. Përjashtohen nga pagimi i taksës mbi kalimin e së drejtës së pronësisë për pasuritë e paluajtshme:

- a) Enti Kombëtar i Banesave, Ministria e Financave dhe organet e qeverisjes qendrore e vendore;
- b) personat, të cilët janë subjekt i tatimit mbi të ardhurat vetjake, në mbështetje të ligjit nr.8438, datë 28.12.1998 "Për tatimin mbi të ardhurat";
- c) subjektet që dhurojnë pasuri të paluajtshme kur përfitues të drejtpërdrejtë janë:
 - i. institucionet dhe entet shtetërore e publike, qendrore e vendore;
 - ii) bashkësitë fetare ose organizatat jofitimprurëse, kur dhurimi lidhet me atë pjesë të veprimtarisë së tyre pa qëllim fitimi. Në këto raste dhuruesi, pasi ka marrë vërtetimin nga këshilli bashkiak për përjashtimin nga taksa, bën regjistrimin e pasurisë së paluajtshme të dhuruar. Në çastin e regjistrimit, dhuruesi paguan pjesën që i takon agjentit të taksave.

2. Në rastet kur pranohet nga vetë palët ose kur vërtetohet ligjërisht simulim i dhurimit për llogari të një shitjeje, për shmangie nga taksa, zbatohen taksa sa dyfishi i vlerës, pavarësisht nga përgjegjësitë e tjera sipas ligjeve në fuqi.

5. Taksa e tabelës:

	Kategoritë	Nj/matëse	Niveli i taksës
1.	Tabelë për qëllime identifikimi, të trupezuara ose jo, brenda territorit ku zhvillohet veprimtaria e biznesit dhe që nuk përdoret për të reklamuar veprimtarite e te treteve(ku shënohet emri ose aktiviteti i biznesit)		
a.	Deri ne 2 m²	lekë/m ² /vit	0 lekë
b.	Mbi 2 m² deri 10 m²		
	-e thjeshte (pa ndiricim)	lekë/m ² /vit	7.000 leke
	-me ndricim të thjeshte	lekë/m ² /vit	11.500 leke
	-elektronike	lekë/m ² /vit	15.000 leke
c.	Mbi 10 m² deri 20 m²		
	-e thjeshte (pa ndiricim)	lekë/m ² /vit	5.950 lekë
	-me ndricim të thjeshte	lekë/m ² /vit	9.775 lekë
	-elektronike	lekë/m ² /vit	12.750 lekë



d.	Mbi 20 m² deri 40 m²		
	-e thjeshte (pa ndiricim)	lekë/m ² /vit	2.800 lekë
	-me ndricim te thjeshte	lekë/m ² /vit	4.600 lekë
	-elektronike	lekë/m ² /vit	6.000 lekë
II.	Tabela për qëllime identifikimi jashtë territorit ku zhvillohet veprimtaria e biznesit në formën dhe permasat e tabelave për orientim		
	-tabela identifikuese	lekë/m ² /vit	120 lekë
III.	Tabela per qellime reklamimi e levizshme, e pa levizshme		
	-e thjeshte (me/ pa ndricim)	lekë/m ² /vit	13.500 lekë
	-elektronike	lekë/m ² /vit	27.000 lekë
IV.	Tabela në funksion të ekspozimeve të ndryshme të hapura, panaire, spektakle, stenda reklamuese, banderola, etj.		
	-te te gjitha llojeve të permasave	lekë/m ² /ditë	1.000 lekë

Shënim: Perfitim ulje për Taksën e Tabelës me 5% të gjithë bizneset që paguajn brenda datës 30 prill.

1. Detyrimi për Taksën e Tabelës për kategorinë I dhe II është vjetor.
2. Afati i njoftimit të tatimpaguesit do të jetë deri në datën **31.03.2026**.
3. Për “kategoritë I dhe II” për subjektet ekzistuese detyrimi paguhet brenda datës **30.06.2026**. Për subjektet që duan të identifikohen me tabel të re pas datës **30.06.2026**, detyrimi llogaritet dhe paguhet menjëherë për periudhën nga momenti i deklarimit.
4. Për subjektet taksapagues qe vendosin me shume se nje table identifikuese , vetem njera nga dy tabelat identifikuese do te konsiderohet e tille, kurse tabela tjetere do te konsiderohet si reklame.
5. Për subjektet e reja detyrimi tatimor do të llogaritet që nga muaji pasardhës që subjekti regjistrohet në QKB dhe taksa paguhet menjëherë. Taksa e tabelës për qëllime identifikimi paguhet për çdo njësi ku subjekti kryen aktivitet, nga muaji pasardhës që regjistrohet pranë QKB.
6. Për “kategorinë III” për subjektet ekzistuese detyrimi paguhet brenda datës **30.06.2026**. Subjektet e reja paguajnë detyrimin menjëherë sipas periudhës së përcaktuar në kontratë e nënshkruar me strukturat përkatëse ne Bashkinë Belsh.
7. Për “kategorinë IV” detyrimi llogaritet sipas ditëve të përcaktuar në lejen përkatëse të lëshuar nga strukturat përkatëse të Bashkis Belsh dhe paguhet menjëherë.
8. Taksa e tabelës zbatohet për të gjitha subjektet, të cilat vendosin tabela, të lëvizshme apo të palëvizshme, për të identifikuar veprimtarinë e tyre ose për qëllime reklamimi të veprimtarisë së tyre apo dhe për të tretët, që vendosen në pamje ballore të vendodhjes së veprimtarisë, brenda territorit të përbashkët në qendrat tregtare, ose në hapsira jashtë vendndodhjes së veprimtarisë, këto publike ose private.
9. Taksa e tabelës është vjetore. Bën përjashtim rasti kur tabela vendoset në funksion të ekspozimeve të ndryshme të hapura, panaire, spektakle, stenda reklamuese, banderola



etj., për të cilat taksa llogaritet dhe paguhet vetëm për periudhën kohore të lejes së dhënë nga strukturat e Bashkis Belsh.

10. Tabela përmban shkronja, logo, simbole apo figura, që mundësojnë indentifikimin e veprimtarisë së taksapaguesit apo që shërbejnë për qëllim orjentimi, reklamimi ose ekspozimi. Si bazë vlersimi për llogaritjen e taksës shërben sipërfaqja në metër katror që zë tabela në të gjithë shtrirjen e saj.
11. Kur në sipërfaqen e tabelës indentifikuese përfshihen edhe shkronja, simbole dhe figura për qëllime reklamimi të një apo më shumë produkteve shërbimeve që furnizohen nga vetë njëësia, ku është vendosur tabela, kjo tabelë vendoset si tabelë indentifikuese dhe taksa llogaritet për këtë kategori table. Në rast të kundërt, tabela vlersohet si tabelë reklamimi dhe taksa llogaritet për tabelën për qëllime reklamimi.
12. Struktura e ngarkuar për mbledhjen e kësaj takse është Zyra e Tatim-Taksave Bashkia Belsh.
13. Për mospagesë në afatin e caktuar do të zbatohen procedurat për marrjen e masave të detyrimit tatimor sipas ligjit nr 9920, date 19.05.2008, "Per Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë" dhe do të aplikohet gjobë në masën 1.8% çdo muaj vonesë, por jo më shumë se 12 muaj.

TAKSA E NDARA

Kapitulli II:

I. Taksa e ndara.

"Taksë ose tatim i ndarë" është një taksë kombëtare ose tatim i përcaktuar sipas ligjit për procedurat tatimore ose ligjeve të veçanta tatimore, të ardhurat respektive prej të cilave ndahen, plotësisht ose pjesërisht, me njësitë e vetëqeverisjes vendore. Njësitë e vetëqeverisjes vendore marrin një përqindje nga taksat ose tatimet kombëtare që realizohen në juridiksionin e tyre. Të ardhurat e arkëtuara nga taksat e ndara transferohen te njësitë e vetëqeverisjes vendore deri në fund të muajit pasardhës. Në rastet e ndryshimeve në politikën fiskale, që shoqërohen me ulje të niveleve, normave dhe taksave të ndara, njësitë e vetëqeverisjes vendore kompensohen financiarisht, në përputhje me nivelin e uljes së të ardhurave.

a) Taksa e mjeteve të përdorura të transportit.

Baza e taksës: Lloji i mjetit të transportit rrugor është bazë për taksën: Cilindrata në cm³ x koeficienti fiks sipas vjetërsisë x taksa fikse për llojin e karburantit. Detyrimi për pagimin e taksës i takon pronarit të mjetit.

- Strukturat përgjegjëse për vjeljet e taksës: E ardhura nga taksa, për çdo rast, mbledhet nga strukturat e Drejtorisë së Përgjithshme të Shërbimeve të Transportit Rrugor, drejtoritë rajonale, para kryerjes së kontrollit teknik vjetor të detyrueshëm të mjetit. Bazuar në numrin e mjeteve të regjistruara sipas njësive të qeverisjes vendore, 25 për qind e të ardhurave vjetore nga kjo taksë, i kalojnë si të ardhura buxhetit të qeverisjes vendore.

b) Taksa e rentës minerare.

Baza e taksës: Çdo person fizik apo juridik, që është i licencuar dhe/ose vepron në industrinë minerare, sipas një marrëdhënieje kontraktuale me ministrin përgjegjës për ekonominë, duhet të paguajë rentë minerare për burimet natyrore që nxjerr nga nëntoka. Renta minerare llogaritet si detyrim mujor i subjektit taksapagues, në çastin kur ai shet produkte minerare.



- Strukturat përgjegjëse për vjeljet e taksës: Degët e doganave në rrethe ngarkohen për arkëtimin e kësaj rente, në rastin e eksportit të produkteve minerare, ndërsa degët e tatimeve ngarkohen për arkëtimin e kësaj rente, në rastin e shitjes së produkteve minerare brenda vendit. 5 për qind e të ardhurave nga renta minerare i takojnë Bashkisë Belsh, ku zhvillohet veprimtaria.

c) **Të ardhura nga tatimi mbi të ardhurat personale.**

Baza e taksës: Tatimi mbi të ardhurat personale, llogaritet mbi të ardhurat e individëve. Njësitë e vetëqeverisjes vendore përfitojnë si taksë të ndarë, 2 (dy) për qind e të ardhurave nga tatimi mbi të ardhurat personale.

- Strukturat përgjegjëse për vjeljet e taksës: Drejtoritë rajonale të tatimeve janë përgjegjëse për arkëtimin. Ministria e Financave shpërndan të ardhurën takuese për Bashkinë Belsh.

TARIFAT VENDORE

Kapitulli III:

1. Tarifë Vendore

Njësitë e vetëqeverisjes vendore kanë të drejtë të vendosin tarifa për një shërbim që këto njësi ofrojnë apo për një të drejtë që u jepet individëve, personave fizikë dhe/ose juridikë.

Niveli i tarifës orientohet në mbulimin e kostos së shërbimit publik të ofruar nga njësi e vetëqeverisjes vendore.

Njësitë e vetëqeverisjes vendore mund të vendosin tarifa vetëm për shërbimet publike, konsumi ose përfitimi i të cilave, në parim, është i matshëm për përdoruesit apo përfituesit, duke përdorur instrumente të përshtatshme për të siguruar aksesin, cilësinë, sasinë dhe kostone përbalueshme nga të gjithë.

Ky kapitull trajton tarifatat vendore në mënyrë nominale duke u nisur nga elementët:

- Llojit të shërbimit, baza e taksueshme, kategorizimet dhe nënkategorizimet, këstet e pagimit, koha e kryerjes së tyre, kushtet lehtësuese, strukturat përgjegjëse për vjeljen e detyrimeve dhe agjentët tatimorë.

- a) Tarifë pastrimi, Tarifë Ndriçimi, Tarifë Gjelbërimi, Tarifë Zgjatje orari Non Stop, Tarifë Shërbimi.

Përkufizimi:

Tarifë e pastrimit: është një pagesë, që bëhet drejtpërdrejt apo nëpërmjet një nëpunësi tek administrata tatimore vendore në shkëmbim të shërbimit të marrë, për një familje, person fizik apo juridik, vendas ose të huaj, që banojnë/janë rezidentë dhe ushtrojnë veprimtari ekonomike brenda territorit të Bashkisë Belsh dhe njësisive të saj administrative. Niveli i tarifës së pastrimit: Kategoritë, nënkategoritë dhe nivelet treguese janë të shprehura si më poshtë:

Tarifa e ndriçimit: është një pagesë, që bëhet drejtpërdrejt apo nëpërmjet një nëpunësi tek administrata tatimore vendore në shkëmbim të shërbimit të marrë, për një familje, person fizik apo juridik, vendas ose të huaj, që banojnë/janë rezidentë dhe ushtrojnë veprimtari ekonomike brenda territorit të Bashkisë Belsh dhe njësisive të saj administrative. Kategoritë, nënkategoritë dhe nivelet treguese të tarifës së gjelbrimit, janë të shprehura si më poshtë:

Tarifa e gjelbrimit: është një pagesë, që bëhet drejtpërdrejt apo nëpërmjet një nëpunësi tek administrata tatimore vendore në shkëmbim të shërbimit të marrë, për një familje,



person fizik apo juridik, vendas ose të huaj, që banojnë/janë rezidentë dhe ushtrojnë veprimtari ekonomike brenda territorit të Bashkisë Belsh dhe njërive të saj administrative. Kategoritë, nënkategoritë dhe nivelet treguese të tarifës së gjelbrimit, janë të shprehura si më poshtë:

Nr.	Lloji tarifës	Njësia.	Niveli i tarifës.	
I.	Tarife e pastrimi:		Belsh Qëndër	Njësi Administrarive dhe periferi.
a.	Familje.	lekë/vit	1,200	1,200
b.	Njësi shërbimi. bar-kafe, kafe internet, pranë pedonale (Sami Frashëri).	lekë/vit	12,000	-
c.	Biznes i vogël. Shitje me pakic, bar-kafe, noter, berber, riparime elektro shtëpiake, dyqane veshjeve, fruta perime, lavazh, parfumeri, argjendari, restorante me sipërfaqe të vogël, e të tjera të ngjashme me to.	lekë/vit	10,000	7,000
ç	Njësi shërbimi, barakat, këpucar, kur subjekti ka një sipërfaqe të vogël për m ² .	lekë/vit	8,000	5000
d.	Tregti ushqimore-industriale, Punishte rakije, Fabrik mielli(tarifë fikse) e të tjera të ngjashme me to.	lekë/vit	10,000	10,000
dh.	Furrë buke, Mini market, Piceri, Fast-food, Servis motorrash, Shërbime Funerali të ngjashme me to.	lekë/vit	15,000	10,000
e.	Fabrika vaji (punishte vaji) tarif fikse	lekë/vit	15,000	15,000
ë.	Mobileri, Marangoz, Zdruktari, Punim alumini, Perpunim qumshti, Përpunim mermeri, Tregti te imputeve, Pesticideve, Plerave kimike, Farmaci, Klinik dentare, Farmaci veterinare, Servis Makinash, Elektroaut, Agjensi të ndryshme, e të tjera të ngjashme me to.	lekë/vit	20,000	15,000
f.	Njësi tregtare "prodhim dhe tregtim" me sipërfaqe mbi 400-800 m ² (magazine, dyqane etj) tarifë fikse kur ka dy adresa, e të tjera të ngjashme me to.	lekë/vit	40,000	20,000
g.	Subjektet e kabllorit dhe internetit, TV kabllor etj.	lekë/vit	30,000	25,000
gj.	Gurore etj.	lekë/vit	40,000	40,000
h.	Bar Restorante deri në 100 m ²	lekë/vit	15,000	10,000
i.	Bar Restorante.(sall dasmash).mbi 200-500 m ²	lekë/vit	30,000	15,000



j.	Karburantet (selia qendrore).	lekë/vit	30,000	20,000
k.	“Tregti ushqimor me shumicë” dhe pakic me qëllim rishitjen e mallrave, Biznes i madh ku zhvillohen disa aktivitete njëkohësisht (magazine, dyqane me sipërfaqe 500-800 m ²) tarif fikse kur ka dy adresa.	lekë/vit	100,000	80,000
l.	Drejtoria e Shërbimit Spitalor, Zyra Arsimore, Zyrat Postare Njësi Administrative etj.	lekë/vit	30,000	20,000
ll.	Banka, Institucionet e Telekomunikacionit, Shoqëri Kursim Krediti, Kompanit e Sigurimit, Veprimtari mediatike. OSSHE, Posta sha (Qëndër) ,Ujsjells sha, Materjale ndertimi Nj. Administrative. e të tjera të ngjashme me to.	lekë/vit	50,000	35,000
m.	Supermarket, Hidrosanitare biznes i madh fizik, juridik e të tjera të ngjashme me to.	lekë/vit	80,000	40,000
n.	Biznes i madh me TVSH. Qendëra tregtare ku ushtrohen disa aktivitete njëkohësisht.	lekë/vit	100,000	50,000
o.	Institucioni i Ekzekutimit te Vendimeve Penale	lekë/vit	150,000	
p.	OJF.	lekë/vit	2,000	2,000
Tarifë për subjektet që realizojnë projekte me fondet e Bashkis Belsh (në propocion të drejtë me afatin e lejes)				
a.	Për vlera investimi nga 5.000.000-10.000.000 lekë	lekë/vit	50,000	50,000
b.	Për vlera investimi nga 10.000.000-50.000.000 lekë	lekë/vit	100,000	100,000
c.	Për vlera investimi mbi 50.000.000 lekë	lekë/vit	150,000	150,000
Tarifë për subjektet që realizojnë projekte me fondet shtetërore (në propocion të drejtë me afatin e lejes)				
a.	Për vlera investimi nga 5 000 000-10 000 000 lekë	lekë/vit	100,000	100,000
b.	Për vlera investimi nga 5 000 000-10 000 000 lekë	lekë/vit	150,000	150,000
c.	Për vlera investimi mbi 50.000.000 lekë	lekë/vit	200,000	200,000
Tarifë pastrimi për subjektet që shfrytëzojnë sipërfaqet liqenore për të kryer aktivitetin ripopullim,zënie dhe tregtim peshku.				
l.l	Sipërfaqja e liqenit në ha.	Njësia.	Niveli i tarifës.	
a.	0.1-10 ha	lekë/vit	10,000	
b.	10-20 ha	lekë/vit	15,000	
c.	20-30 ha	lekë/vit	20,000	
ç.	30-40 ha	lekë/vit	25,000	



d.	40-50 ha	lekë/vit	30,000
dh.	mbi 50 ha	lekë/vit	40,000
TARIFË NDRIÇIMI			
2.	Tarifa e ndriçimit:	Njësia.	Niveli i tarifës.
a.	Familje.	lekë/vit	500
b.	Biznes i vogël, bar-kafe, kafe internet, pranë pedonales Sami Frashëri.	lekë/vit	5,000
c.	Qëndrat Shëndesore në Nj.Administrative, Posta në Nj.Administrative, Gurorë, Farmaci(<i>Veterinare, Bujqësore</i>), Tregti inputesh, e të tjera të ngjashme me to.	lekë/vit	3,500
ç.	Biznes i vogël (rreth liqenit të Belshit).	lekë/vit	3,500
d.	Biznes i vogël (Belsh Qëndër) e të tjera të ngjashme me to.	lekë/vit	2,500
dh.	Biznes i madh. Punishte vaji, Tv kabllor, Restorant dasmash, e të tjera të ngjashme me to.(Nj.Administrative).	lekë/vit	2,500
e.	Biznes i vogël (Njësi Administrative dhe periferi). e të tjera të ngjashme me to.	lekë/vit	1,500
ë.	Biznes i vogël taksì, transport mallrash 0-3.5 ton.	lekë/vit	1,000
f.	Institucione, Sha, Shpk, Njësi bankare e të tjera të ngjashme me to.	lekë/vit	8,000
g.	Biznes i madh fizik , juridik. e të tjera të ngjashme me to.	lekë/vit	10,000
gj.	Subjektet që realizojnë projekte me fondet Bashkiake dhe Shtetore (fikse).	lekë/vit	10,000
h.	OJF	lekë/vit	300
TARIFË GJELBËRIMI			
3.	Tarifa e gjelbërimit:	Njësia.	Niveli i tarifës.
a.	Familje.	lekë/vit	200
b.	Biznes i vogël (pranë sheshit Sami Frashri)	lekë/vit	1,500
c.	Biznes i vogël.	lekë/vit	1,000
ç.	Biznes i madh Sha, Shpk/Institucione.	lekë/vit	2,000
d.	Subjektet që realizojnë projekte me fondet Bashkiake dhe Shtetore (fikse).	lekë/vit	3,000
TARIFË ZGJATJE ORARI			
4.	Tarifë për zgjatje orari.	Njësia.	Niveli i tarifës.
a.	“Non Stop” për një natë.	lekë/ditë	2,500
b.	Deri në orën 24 ⁰⁰	lekë/vit	10,000
c.	“Non Stop”	lekë/vit	20,000
TARIFË SHËRBIMI			
5.	Tarifë shërbimi në tregje.	Njësia.	Niveli i tarifës.
a.	Artikuj të ndryshëm, fruta perime.	lekë/m ² /ditë	50



b.	Peshk, zogjë fushe etj.	lekë/m ² /ditë	100
c.	Tregtarët ambulant(B.Belsh)	lekë/ditë	200
ç.	Tregtarët ambulant, muzikant (B.Belsh)	lekë/vit	5,000
d.	Tarifë vërtetimi.	lekë/vërtetim	100
e.	Tarifë librezë.	lekë/copë	50
ë.	Tarifë për vaditje.	lekë/dylim	300

Shënim: Perfitim ulje për tarifën pastrimi, ndriçimi, gjelbërimi, me 5% të gjithë bizneset që paguajn brenda datës 30 prill.

1. Struktura e ngarkuar për vjeljen e tarifave familjare dhe tarifave për biznesin është Zyra e Tatim-Taksave Bashkia Belsh (pagesa kryhet pranë arkës së bashkis dhe në çdo bankë te nivelit të dytë).
2. Periferi do të quhen fshatrat Çepë, Seferan, Dushk, Marinëz, Shtith, Shkozë, Shkëndi, Stanaj, Qafëshkall.
3. Përfshihen nga tarifën për 6-mujorin e parë çdo biznes i ri me sipërmarrës nga moshën 18-35 vjeç.
4. Për subjektet familje **afati i pagesës është data 31.12.2026** (kjo pagesë mund të kryhet pranë zyrës së Tatim Taksave Bashkia Belsh dhe në zyrat e Njësive Administrative Kajan, Grekan, Fierzë, Rrasë).
5. Përfshihen nga kjo tarifa (pastrim, ndriçim, gjelbërim) familjet që trajtohen me ndihmë ekonomike, personat me aftësi të kufizuar, invalidë, paraplegjikë dhe tetraplegjikë, të verbër, kur janë kryefamiljarë dhe nuk kanë persona të tjerë madhor në familje. **-Librezën përkatëse.**
6. Për subjektet që kanë adresë dytësore pagesa e tarifave të pastrimit, ndriçimit dhe gjelbërimit përgjyemohet (shembull: $Tarifa\ e\ pastrimit: 20.000 \div 2 = 10.000$) etj.
7. Ambulantë menaxhohen nga Sektori i Trgut dhe në fillim të vitit lidhin një kontratë (vetëm për ambulantët me banim në B.Belsh), kundrejt pagesë prej 5.000 (pesë mijë) lekë. Në bazë të pagesës si ambulant, tarifën e miratuar bëhen 0 lekë.
8. Tarifa e pastrimit do të aplikohet për të gjitha familjet ku ofrohet shërbimi, personat fizikë ose juridikë, vendas ose të huaj, që banojnë/janë rezidentë dhe ushtrojnë veprimtari ekonomike në Bashkinë Belsh, kurse tarifa e ndriçimit publik dhe e gjelbërimit paguhet vetëm nga ato familje dhe biznese që u ofrohet ky shërbim.
9. Familjet të cilave, shërbimi i ofruar nga Bashkia Belsh, u kalon distanca prej **500 m** largësi nga shërbimi i ofruar përfshihen nga tarifën (pastrim, ndriçimi).
10. Tarifa për vaditje është tarifë vendore për popullatën dhe paguhet në momentin kur çdo subjekt familjar kërkon të vadisë sipërfaqen e mbjellë, në bazë të dylimeve që deklaron pra inspektorit të vaditjes. Për këtë pagesë ngarkohen inspektorët e vaditjes të cilët në fundë bëjnë derdhjet e pagesave pranë arkës së Bashkisë Belsh.
11. Afati i njoftimit të tatimpaguesit do të jetë deri në datën **31.03.2026**.
12. Afati i pagesës së detyrimit është data **30.06.2026**.



13. Për mospagesë në afatin e caktuar do të zbatohen procedurat për marrjen e masave të detyrimit tatimor sipas ligjit nr 9920, date 19.05.2008, “Per Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë” dhe do të aplikohet gjobë në masën 1.8% çdo muaj vonesë, por jo më shumë se 12 muaj.

b) Tarifë për dhënien në përdorim të ambjenteve;

Nr.	Emërtimi	Tarifa/ditë
1.	Dhënie në përdorim e shtëpisë së kulturës për aktivitete partiake (për një ditë)	20,000 lekë
2.	Dhënie e shtëpisë së kulturës për aktivitete kulturore dhe fetare (për një ditë)	5,000 lekë
3.	Dhënie e shtëpisë së kulturës për aktivitete Shkollore	0
4.	Tarifë për të gjithë subjektet fizik/juridik që duan të shfrytëzojnë hapësirën publike në rastë festë, evente, panaire, organizime të ndryshme.	20,000 lekë

1. Struktura e ngarkuar për vjeljen e kësaj tarife është Zyra e Tatim-Taksave Bashkia Belsh.
2. Detyrimi llogaritet sipas ditëve të përcaktuar në lejen përkatëse të lëshuar nga strukturat përkatëse të Bashkis Belsh dhe paguhet menjëherë.

c) Tarifa për zënien e hapësirave publike.

Nr.	Zënie e hapësirës publike.	Nj/matëse.	
1.	Zënie e hapësirës publike për qëllime biznesi në sheshit Ansambli.	200 lekë/m ² /muaj	
2.	Zënie e hapësirës publike për qëllime biznesi jashtë sheshit Ansambli. Rruga 31 gusht, Rruga Spitalit-çezma e vjetër, rruga Belsh Qëndër-Posta Shqipëtare	100 lekë/m ² /muaj	
3.	Zënie e hapësirës publike për qëllime biznesi për të gjitha bizneset që janë largë B.Qëndër dhe Njesit Administrative.	60 lekë/m ² /muaj	
4.	Zënie e hapësirës publike për qëllime biznesi nga subjektet jo rezidentë (lodra për fëmijë).	20,000 lekë/muaj	
a.	Tarifë pastrimi:(për 1-një muaj qëndrimi jo rezidentë)	lekë/fikse	10,000
b.	Tarifë ndriçimi:(për 1-një muaj qëndrimi jo rezidentë)	lekë/fikse	10,000
c.	Tarifë gjelbërimi:(për 1-një muaj qëndrimi jo rezidentë)	lekë/fikse	2,000



Shënim: Perfitim ulje për Tarifën e zënies së hapsirave publike me 5% të gjithë bizneset që paguajn brenda datës 28 shkurt.

1. Tarifa e hapsirës publike llogaritet duke shumëzuar sipërfaqen e zënë me nivelin tregues të tarifës dhe numrin e muajve për të cilin merret në përdorim.
2. Tarifa e hapsirës publike është tarifë vjetore dhe paguhet në momentin e lidhjes së kontratës me strukturat përkatëse.
3. Tarifa e hapsirës publike për subjektet që nuk kanë një struktur provizore pagesa mund të behet për 8 (tetë) muaj të vitit, vetëm në raste kur subjekti e kthen hapsirën publike në gjëndjen e mëparshme.
4. Tarifa e pikës 4 paguhet në momentin e lidhjes së kontratës me strukturat përkatëse në Bashkinë Belsh dhe sipas kushteve të përcaktuara në këtë kontratë.
5. Struktura e ngarkuar për vjeljen e kësaj tarife është Zyra e Tatim-Taksave Bashkia Belsh.

2. Tarifa për transportin.

a) Tarifa për liçensa/autorizime/çertifikata.

Nr.	Emërtimi	Njësia	Tarifa
1	TRANSPORT UDHËTARËSH		
a.	Licencë për "Transport Udhëtarësh" në linjë të rregullt qytetëse	Për licencë	40.000 lekë/5 vjet
b.	Çertifikatë për "Transport Udhëtarësh" në linjë të rregullt qytetëse	Për mjet	7.500 lekë/5 vjet
c.	Licencë për "Transport Udhëtarësh" në linjë të rregullt rrethqytetëse	Për licencë	30.000 lekë/5 vjet
ç.	Çertifikatë për "Transport Udhëtarësh" në linjë të rregullt rrethqytetëse	Për mjet	7.500 lekë/5 vjet
d.	Licencë për "Transport Udhëtarësh" në linjë të rregullt ndërqytetëse brënda qarkut	Për licencë	75.000 lekë/5 vjet
dh.	Çertifikatë për "Transport Udhëtarësh" në linjë të rregullt ndërqytetëse brënda qarkut	Për mjet	7.500 lekë/5 vjet
e.	Licencë për transport Udhëtarësh" në linjë të rregullt ndërqytetëse ndërmjet qarqeve	Për licencë	75.000 lekë/5 vjet
ë.	Çertifikatë për "Transport Udhëtarësh" në linjë të rregullt ndërqytetëse ndërmjet qarqeve	Për mjet	7.500 lekë/5 vjet
f.	Li çencë për agjensi udhëtarësh	Për	15.000



		liçencë	lekë/vit
g.	Li çencë per transport udhetaresh me taksi	Për liçencë	25.000 lekë/5 vjet
2.	TRANSPORT MALLRASH		
a.	Çertifikatë transporti malli për të tretë dhe me qera vjetore	Ton/kapci tet	100 lekë (1 vjekar)
b.	Çertifikatë transporti malli për llogari të vet	Ton/kapci tet	100 lekë (1 vjekar)
c.	Çertifikatë për tërheqës dhe makineri shpimi	Për mjet	1.500 lekë/vit
ç.	Liçencë për transport mallrash për të tretë dhe me qera brënda vëndit	Për mjet	40.000 lekë/5 vjet
3.	TARIFË VJETORE PARKIMI/QËNDRIMI		
a.	Për taksi 4+1,taksi 8+1 dhe minibus deri në 25 vënde	Për mjet	5.000 lekë/vit
b.	Për autobus mbi 25 vënde	Për mjet	9.000 lekë/vit
c.	Për transport malli deri 5 ton	Për mjet	3.000 lekë/vit
ç.	Për transport malli 5-8 ton	Për mjet	4.000 lekë/vit
d.	Për transport malli 8- 12 ton	Për mjet	5.000 lekë/vit
dh.	Për transport malli mbi 12 ton	Për mjet	6.000 lekë /vit
4.	TARIFË PARKIMI I REZERVUAR		
a.	Tarife parkimi e rezervuar	Për mjet	35.000 lekë /vit
b.	Tarifë parkimi i rezervuar mujor	Për mjet	3.500 lekë/muaj
c.	Tarifë parkimi ditor	Për mjet	250 lekë/ditë
d.	Tarifë parkimi ditor/orë	Për mjet	50 lekë/orë
5.	ANKORIM NË MOLIN E LIQENIT, PËR BARKAT ME/PA MOTORR DHE ANIJET.		
a.	Ankorim ne molin e liqenit, për Barkat me motorr,dhe	Për mjet	20.000



	anijet		lekë/vit
b.	Ankorim ne molin e liqenit, për Barkat pa motorr,dhe anijet	Për mjet	2.000 lekë/vit
6.	TARIFË PASTRIMI PËR SUBJEKTET E TRANSPORTIT		
a.	Për taksì 4+1.minibus.autobuz	Për mjet	5.000 lekë/vit
b.	Për transport malli deri në 5 ton	Për mjet	2.500 lekë/vit
c.	Për transport malli 5-8 ton	Për mjet	3.500 lekë/vit
ç.	Për transport malli 8-12 ton	Për mjet	4.000 lekë/vit
d.	Për transport malli mbi 12 ton	Për mjet	5.000 lekë/vit
7.	TARIFA TË TJERA TRANSPORTI		
a.	Autorizim ditor(për transport udhëtarësh me autobus jashtë linje për vizita,eskursione etj -Për brenda rrethit (Për autorizim) -Për jashtë rrethit (Për autorizim)	Për mjet	200 lekë/ditë 500 lekë/ditë
b.	Leje ditore për hyrje në qytet	Për mjet	500 lekë/ditë
c.	Leje mujore për hyrje në qytet	Për mjet	2.000 lekë /muaj
ç.	Leje tre mujore për hyrje në qytet	Për mjet	5.000 lekë

1. Struktura e ngarkuar për vjeljen e kësaj tarife është Sektori i Transportit dhe Zyra e Tatim-Taksave Bashkia Belsh.
2. Afati i pagesës së detyrimit për mjetet e transportit publik është data 31.12.2026.
3. Për mospagesë në afatin e caktuar do të zbatohen procedurat për marrjen e masave të detyrimit tatimor sipas ligjit nr 9920, date 19,05.2008, "Per Procedurat Tatimore në Republikën e Shqiperisë" dhe do të aplikohet gjobë në masën 1.8% çdo muaj vonesë, por jo më shumë se 12 muaj.
4. Struktura e ngarkuar për vjeljen e tarifës për pikën **nr.4**(parkimi e rezervuar)është Green Belsh sh.a.



b) Tarifë për liçencë për tregtimin e hidrokarbureve dhe nënprodukteve të tyre.

(Kjo tarifë zbatohet në përmbushje të V.K.M.nr. 970 datë 02.12.2015 "Për përcaktimin e procedurave dhe të kushteve për dhënien e lejeve dhe të liçensave për tregtimin e naftës, gazit e të nënprodukteve të tyre" i ndryshuar, v.k.m nr.344, date 19.4.2017, "Për disa ndryshime dhe shtesa në vendimin nr. 970, date 2.12.2015, për të gjitha ato stacione të shitjes së karburanteve,që ushtrojnë veprimtarinë e tregtimit të karburanteve për automjete,gazit të lëngshëm e vajrave lubrifikante dhe të njësive të shitjes së lëndëve djegëse,që ushtrojnë veprimtarinë e tregtimit të tyre për përdorim nga konsumatorët fundore).

Dhënia e licencave për stacionet e shitjes së karburanteve, për tregtimin me pakicë të karburanteve, gazit të lëngshëm të naftës, për automjetet, e vajrave lubrifikante dhe të njësive të lëndëve djegëse për përdorim nga konsumatorët fundorë, bëhet nga Bashkia Belsh, në rastet kur stacionet e shitjes së karburanteve, që ushtrojnë veprimtarinë e tregtimit të karburanteve për automjete, gazit të lëngshëm e vajrave lubrifikante dhe të njësive të shitjes së lëndëve djegëse, që ushtrojnë veprimtarinë e tregtimit të tyre për përdorim nga konsumatorët fundorë, do të ndërtohen në territor të saj.

Njësiti e tregtimit të naftës,të gazit dhe nënprodukteve të tyre.				
1	Liçensë për tregtimin me pakicë të karburantëve, GLN-ve për automjete e vajrave lubrifikante.	Për liçensë	1.000.000 lekë.	Nga 1 deri në 5 vjet
2	Liçensë për njësiti e shitjes së lëndëve djegëse për ngrohje dhe gatim (GLN).	Për liçensë	100.000 lekë.	Nga 1 deri në 5 vjet

1. Struktura e ngarkuar për vjeljen e kësaj tarife është Zyra e Tatim-Taksave në Bashkia Belsh.

3. Tarifa vendore për pyjet dhe kullotat edhe sektorin e bujqësisë.

a) Tarifa për pyjet dhe kullotat;

Nr.	Emërtimi	Njësia	Vlera e Tarifës
1.	Tarifë për shërbimet profesionale që kryhen në fondin pyjor privat.	lekë/shërbim	300
2.	Tarifë për shitjen e vërtetimit, për levizjen e produkteve drusore dhe jodrusore pyjore.	lekë/copë	200
3.	Tarifë për vërtetim.	lekë/copë	200
4.	Tarifë për prerje druri për nevoja familjare në pyjet vendore të miratuara.	lekë/m ³	300



1. Strukturat e caktuara për mbledhjen e këtyre tarifave është Drejtoria e Zhvillimit të Bujqësis, Pyjeve dhe Mjedisit (Sektori i keshillimit dhe shërbimeve bujqësor, shërbimit veterinar dhe administrimit, mbrojtjes së tokës dhe monitorimit të pyjeve) edhe Njësitë Administrative në Bashkin Belsh.

b) Tarifa për sektorin e bujqësisë.

Nr.	Emërtimi	Njësia	Vlera e Tarifës
1.	Tarifë për vërtetim toke në pronësi ose në përdorim dhe kategoria e saj.	lekë/copë	100
2.	Tarifë për ushtrim aktiviteti bujqësor e blegtoral.	lekë/copë	100
3.	Tarifë për kërkesë për ndryshim të bonitetit të tokave.	lekë/copë	200
4.	Tarifë për kërkesë për aplikim për subvencione bujqësore e blegtorale.	lekë/copë	100

1. Strukturat e caktuara për mbledhjen e këtyre tarifave është Drejtoria e Zhvillimit Ekonomik/Shërbimit Social dhe Bujqësisë, (Sektori i Bujqësis, Pyje dhe Kullota) edhe Njësitë Administrative në Bashkin Belsh.

Kapitulli VI:

GJOBAT DHE KUNDRAVAJTJE ADMINISTRATIVE

Kur nuk përbëjnë vepër penale, përbëjnë kundravajtje administrative:

Nr.	Lloji I gjobës.	Njësia	Niveli I tarifës
Gjoba dhe kundravajtje Administrative.			
1.	Hedhje mbeturinash në rrugë.	lekë	1.000-5.000
2.	Gjobë për ndërhyrjen në rrugë e trotuare.	lekë	10.000-15.000
3.	Gjobë për ndërhyrje në ndricimin public.	lekë	10.000-15.000
4.	Gjobë për bllokimin e rrugëve të arave.	lekë	5.000-10.000
5.	Gjobë për zaptim dhe punim të tokës shtetërore.	lekë	5.000-10.000
6.	Gjobë për therje bagëtish në ambiente publike.	lekë	1.000-5.000



7.	Gjobë për ndërtim pa leje.	lekë	15.000-50.000
8.	Gjobë për ndotje ambjenti.	lekë	25.000-50.000
9.	Gjobë për ushtrimin e aktivitetit të transportit të udhëtarëve pa liçencë.	lekë	1.000-5.000
10.	Hyrja e mjeteve me tonazh të lartë në rrugët kryesore të qytetit pa autorizim.	lekë	1.000-5.000
11.	Mos pajisje me leje për tregtimin e karburanteve dhe bomblave të gazit.	lekë	10.000-20.000
12.	Vendosje tabelash, reklamash, banderolash pa leje.	lekë	1.000 - 10.000
13.	Zënie të hapësirës së gjelbër pa leje.	lekë	5.000-20.000
14.	Dëmtim i hapësirave publike të gjelbërta.	lekë	10.000-20.000
15.	Mos pajisje me leje për tregti ambulante.	lekë	1.000 - 5.000
16.	Mos paisje me leje për shërbim me tavolina jashtë lokalit.	lekë	5.000 - 20.000

1. Struktura e ngarkuar për zbatimin e kësaj pike është sektori i Policisë Bashkiake dhe Inspektoriati Vendor I Mbrojtjes së Territorit (IMT) pranë Bashkisë Belsh.
2. Struktura e ngarkuar për vjeljen e kësaj tarife është Zyra e Tatim-Taksave në bashkpunim me sektorin e Policisë Bashkiake dhe Inspektoriatin Vendor të Mbrojtjes së Territorit (IMT) në Bashkia Belsh.
3. Afati për pagesën e “*gjobave dhe shumave*” bëhet nga kundërvajtësi brenda 10 ditëve, nga data kur është njoftuar për vendimin e dënimit me gjobë.
4. Pas kalimit të këtij afati, për çdo ditë vonesë paguhet kamatë **2%** në muaj të masës së gjobës.

Kapitulli V.

TË ARDHURA JO TATIMORE

a) Të ardhura nga dhënia me qira e aseteve në pronësi të Bashkisë

Sipas përcaktimeve ligjore pasuritë që jepen me qira janë ndërtesat, trualli i lirë, trualli i lirë funksional (jo nënndërtesë), makineritë e pajisjet dhe linjat e prodhimit. Të ardhurat nga qiratë paguhet nga përfituesi dhe shfrytëzuesi i pronës në pronësi të bashkisë, bazuar në kontratën e lidhur mes palëve.



Drejtoria Juridike, Njësia e Prokurimit dhe sektori i Aseteve kryejnë procedurën e plotë të dhënies me qira deri në hartimin e kontratës dhe kërkojnë lëshimin e faturës nga ana e Drejtorisë së Ardhrave. Ndjekja e zbatimit të kontratës kryhet nga Sektori i Aseteve.

b) Të ardhura nga sekuestrime dhe zhdëmtime.

Bazuar në Ligjin Nr.10296, datë 08/07/2010, "Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin" si dhe Udhëzimin nr.30, datë 27.12.2011, "Për Menaxhimin e Aktiveve në Njësitë e Sektorit Publik", të ndryshuar, të gjitha njësitë e sektorit publik kanë detyrimin të marrin masat e nevojshme për dokumentimin, mbrojtjen, qarkullimin dhe nxjerrjen nga përdorimi i aktiveve, me qëllim menaxhimin me efektivitet dhe ruajtjen e tyre nga dëmtimi dhe keqpërdorimi. Nëpunësit Autorizues të të gjithë niveleve të njësisë publike kanë detyrimin që të kryejnë të gjitha analizat deri në vlerësimin për ngarkim të shkaktarëve që lejojnë veprime abuzive në trajtimin e aktiveve.

c) Të ardhura nga shitja e mallrave dhe e shërbimeve.

Sipas përcaktimeve ligjore janë të ardhura që përfshihen në zërin të ardhura nga shitja e mallrave dhe shërbimeve. Aktivitet që pas vlerësimit nxirren jashtë përdorimit, kur mund të përdoren si vjetërsira/mbeturina/materiale të riciklueshme, hiqen nga regjistri i aktiveve në përdorim, bëhen hyrje në magazinë dhe u shiten me ankand ndërmarrjeve që i grumbullojnë.

d) Të ardhura nga shitja e aktiveve të qëndrueshme të trupëzuara

Sipas përcaktimeve në ligjin "Për vetëqeverisjen vendore", akteve normative dhe procedurave ligjore, Bashkitë krijojnë të ardhura nga shitja e aktiveve të qëndrueshme të trupëzuara.

e) Të ardhura nga privatizimi

Baza ligjore për të ardhurat nga privatizimi: VKM nr.97, datë 3.2.2008 "Për procedurat e privatizimit të banesave objekt i ligjit 7652, datë 23. 12.1992, "Për privatizimin e banesave shtetërore" dhe ligjit 9321, datë 25.11.2004 "Për privatizimin e banesave dhe objekteve të kthyer në banesa me fondet të shoqërive dhe ndërmarrjeve shtetërore dhe VKB nr. 153 dt.11.12.2012 "Për miratimin e përfundimit të procedurave të privatizimit të banesave". Të ardhurat nga privatizimi paguhen nga përfituesi i pronës. Drejtoria Juridike ose komisioni përgjegjës përcjell dokumentacionin e përpunuar për lëshimin e faturës te Drejtoria përgjegjëse për të ardhurat, që lëshon faturën për arkëtim.

- ❖ **Shënim:** Çdo subject takspagues ka detyrim ligjor që 15 ditë nga data e rregjistrimit pranë Q.K.B (Qendra e Rregjistrimit të Biznesit), të dorzojë dokumentacionin e plotë pranë zyrës së Tatim-Taksave si mëposhtë vijon:

1.Fotokopje NIPTI

2.Ekstrakt nga Q.K.B

3.Fotokopje e kartes së identitetit

4.Kontrat Qeraje ose dokument i pronsisë(bashkëlidhur kartel, planimetri, planvendosje objektit).

- ❖ Përrjashtohen nga të gjitha taksat dhe tarifat Qendrat Shëndetsore në territorin e Bashkisë Belsh.

KRYETARI I KESHILLIT

Kujtim DERVISHI



Adresa: Qarku Elbasan, Belsh Qender, Rruga Haziz Dervishi,

bashkiabelsh@hotmail.com